

Lezhë, më 28.01.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 28.01.2026, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Janar 2026, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sot kemi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë për muajin janar 2026. Do të zhvillojmë këtë mbledhje me rendin e ditës, i cili është shpërndarë sipas ligjit, javën që shkoi. Në këtë mbledhje, krahas anëtarëve të Këshillit, drejtorive përkatëse të bashkisë, ka dhe një qytetar që ka kërkuar për të marrë pjesë si dëgjues në mbledhjen e sotme. Nisim me rendin e ditës.

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Dhjetor 2025”
2. Projekt-Vendim “Për kriteret për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (Fondi 6%) për vitin 2026”
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e akt-marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Lezhë”
4. Projekt-Vendim “Për një shtesë në Vendimin nr. 116, datë 15.12.2025 “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e qirasë për vitin 2026”
5. Projekt-Vendim “Për një ndryshim në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026””
6. Projekt-Vendim “Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë One Albania sha, për antenat e telefonisë celulare, fshati Balldre, Njësia Administrative Balldre dhe fshati Mabë, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë”
7. Projekt-Vendim “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”
8. Projekt-Vendim “Për shitjen në ankand për skrap të mjeteve të dala jashtë përdorimit”
9. Projekt-Vendim “Për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave në fshatrat ku kryetarët janë të emëruar nga Kryetari i Bashkisë””
10. Projekt-Vendim “Për pranimin si dhurim dhe vendosjen e statujës monumentale “Mbretëresha Teuta”, ofruar nga Fondacioni “Shqipëria Tjetër””
11. Informacion nga Drejtoria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime sha Lezhë
12. Informacion mbi realizimin e buxhetit për 11 mujorin e vitit 2025
13. Të ndryshme

Dhe krahas këtyre kemi dhe dy projekt-vendime shtesë, të cilat janë dërguar tek secili këshilltar, ku i pari është projekt-vendim “Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve dhe mësuesve dhe qendrave të grumbullimit” dhe projekt-vendimi tjetër shtesë “Për miratimin e programit për zhvillimin e aktiviteteve për pritje e përcjellje zyrtare për vitin 2026”.

Ky është rendi i ditës për sot. Kush është dakord me rendin e ditës, ju lutem kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën e parë, Projekt-vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2025”. Ka kush ndonjë gjë? Jo. Atëherë kush është dakord me projekt-vendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika e dytë, Projekt-vendim “Për kriteret për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, fondi 6% për vitin 2026”. Në lidhje me këtë, ka kush diçka? Nga drejtorja e shërbimit social, mund të na thoni diçka.

-Marte Feta: Përshëndetje të gjithëve. Ne të dje ishim edhe në komision dhe i kemi shpjeguar të gjitha projekt-vendimet e drejtorisë së shërbimit të kujdesit social. Por gjithsesi, kriteret janë të vendosura me ligj, por drejtorja e shërbimit dhe kujdesit social, posaçërisht sektori i ndihmës ekonomike, përshtatin me aq mundësi sa i lë ligji, sipas familjeve që gjatë 12 muajve të vitit kanë aplikuar për ndihmën ekonomike. Pra, që do të thotë, nëse ne kemi pasur një familje, që ka pasur fëmijë më shumë ose fëmijë më pak, ose sidomos për t'i dhënë rëndësi të veçantë grave kryefamiljare, kemi bërë kriteret të specializuara sipas targetgrurit të familjeve që aplikojnë. Por këto janë të vendosura me ligj dhe nuk është se ne kemi ndonjë ndryshim nga viti në vit. Nëse ka ndonjë pyetje...

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka kush diçka tjetër? Atëherë kush është dakord me projekt-vendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 3, Projekt-vendim “Për miratimin e akt-marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Lezhë”.

Përsëri nga shërbimi social është ky projekt-vendim. Fjalën e ka drejtoresha.

-Marte Feta: Atëherë, ne gjatë gjithë këtyre viteve, duke qenë se qendrën e moshës së tretë e kemi në bashkë-menaxhim bashkë me Kryqin e Kuq Shqiptar Dega Lezhë, Bashkia e Lezhës ka vendosur që të japë një financim prej 200000 lekësh, të cilat do të përdoren për një kujdestar, një i moshuar, i cili do ta mbajë qendrën e hapur sipas kërkesave që na ka dhënë nga grupi i të moshuarve deri në orën 8:00 të darkës. Dhe pjesën tjetër, mbledhim të gjitha ditëlindjet e muajit dhe festojmë në fund të çdo muaji ditëlindjet e të gjithë moshuarve që brenda një muaji kanë pasur ditëlindjen. Pra, kjo është një mbështetje që jep Bashkia e Lezhës për këtë target grup. Plus, ne çdo vit festojmë dhe ditën e të moshuarve, pra çdo mbështetje që kërkojmë për këtë target grup, edhe me punonjës social dhe me psikolog. Kjo shifër ka dalë e kërkuar nga target grupi i të moshuarve dhe është vendosur nga Bashkia e Lezhës dhe ky fond i kalon Kryqit të Kuq, i cili e ka në menaxhim qendrën tonë të moshës së tretë.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka kush ndonjë gjë tjetër? S'ka. Atëherë, kush është dakord me projekt-vendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 4, Projekt-vendim “Për një shtesë në Vendimin nr. 116, datë 15.12.2025 “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e qerasë për vitin 2026””.

Përsëri, në lidhje me këtë projekt-vendim, është drejtorja e shërbimit social që mund të bëjë sqarimet e nevojshme.

-Marte Feta: Mirë. Siç e dinë të gjithë këshilltarët, në datën 15 dhjetor kemi kaluar të gjitha familjet që kanë plotësuar dosjet sipas afatit për të përfituruar strehimin social. Dhe këtë shtesë ne e bëjmë për 14 familje, të cilat do të shpërngulen nga ambientet që janë të zaptuara, ambientet e Bashkisë Lezhë. Gjatë gjithë kësaj kohe, drejtorja e shërbimit dhe kujdesit social ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me të gjitha këto familje. Me gjithë rezistencën e tyre, ne kemi arritur të kontaktojmë dhe të marrim të dhënat e tyre, çertifikatat e tyre për të plotësuar dosjet. Dhe ne si fillim po planifikojmë fondin, fond i cili vjen totalisht nga Bashkia e Lezhës, që në momentin gjatë vitit që këto familje do të plotësojnë të tjera dokumente që kërkohen për të përfituruar strehimin social, kemi fondin e planifikuar dhe do jenë të mbështetura totalisht nga Bashkia e Lezhës, bonusi i qerasë për të 14 familjet.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush ka diçka tjetër? Nuk ka. Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro.

Vazhdojmë me pikën 5, Projekt-vendim "Për një ndryshim në VKB nr. 113, datë 15.12.2025, për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026".

Kush e do fjalën për këtë projekt-vendim? Atëherë zëvendëskryetarja e bashkisë.

-Brikena Vuksani: Përshëndetje të gjithëve. Atëherë, ky është një projekt-vendim që i takon buxhetit të vitit 2026, konkretisht me një shtesë të ardhurash në kuadër të grantit të performancës që Bashkia e Lezhës ka përfituruar gjatë vitit 2025, për aplikimin e projekteve që ka bërë gjatë këtij viti, janë 55.8 milionë lekë të reja që i shtohen buxhetit të bashkisë, ku 3.2 milionë lekë janë grante që vijnë nga donatorët e huaj. Ministria e Financave ka bërë alokimin e pjesës tjetër gjatë vitit 2025, do të alokohet me tepriçat e vitit, ndërsa pjesa e donatorëve ose financimit të huaj kalon për vitin 2026, të cilat Bashkia e Lezhës ka vendosur që t'i kalojë në kuadër të emergjencave të programi "Rendi dhe Siguria Publike". Janë 3.2 milionë lekë të reja që shkojnë për ndërtimin e dy pritave malore dhe një rikonstruksion ure në fshatin Zejmen, te Njësia Administrative Zejmen.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër? Nuk ka. Kush është dakord me projekt-vendimin? Ju lutem kartonet. Kundra? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro.

Kalojmë te pika 6, Projekt-vendim "Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë One Albania sha, për antenat e telefonisë celulare, fshati Balldre, Njësia Administrative Balldre dhe fshati Mabë, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë".

Në lidhje me këtë projekt-vendim, duhet të sqarojmë që është bërë dëgjese publike nga Këshilli Bashkiak në bashkëpunim edhe me njësitë administrative si të Dajçit, ashtu edhe të Balldrenit. Megjithatë, për sqarime, fjalën e ka drejtori i bujqësisë pranë bashkisë.

-Paulin Gjergji: Përshëndetje të gjithëve. Bëhet fjalë për dhënie toke me qera në Njësinë Administrative Balldre, fshati Balldre dhe Njësinë Administrative Dajç, fshati Mabë. Atëherë,

kjo nuk është ndërtim, aty janë antenat. Kjo është një kontratë e vjetër që me ish-komunat. Kjo kërkon vetëm zgjatjen e dhënies me qera të pronës publike që është në inventar të bashkisë. Të gjitha dokumentet janë paraqitë, me leje mjedisore, leje ndërtimi, për transmetimin e valëve dhe konkretisht ne kemi pasur dhe një akt marrëveshje me kompaninë. Ata kanë kërkuar zgjatjen e kontratës të dhënies me qera që në vitin para, por ne kemi bërë një akt marrëveshje për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025 dhe të gjitha kontratat e qerasë janë paguar. Tani kërkohet thjesht shtyrja e kontratës së dhënies me qera.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Ky projekt-vendim është diskutuar pjesërisht dje gjatë mbledhjes së komisioneve, si edhe në dëgjuesën publike të zhvilluar në 13 janar të këtij viti, me disa banorë të njësive administrative Balldren dhe Dajç. Personalisht jam kundër këtij projekt-vendimi. Jam shprehur kundër edhe gjatë dëgjuesës publike për faktin se thelbi i diskutimit nuk duhet të jetë e miratojmë apo jo ne dhënien në përdorim të një pjese sipërfaqe pyjore kompanisë së telefonisë celulare, por thelbi i diskutimit që duhet të jetë iniciativë edhe e të gjithëve ne këtu në këshill bashkiak, përveçse edhe e Bashkisë Lezhë, duhet të jetë rishikimi i këtyre lejeve mjedisore, rishikimi i vendndodhjes së infrastrukturës së kompanive të telefonisë celulare, zhvendosja e tyre me qëllim që kjo infrastrukturë të mos jetë e dëmshme për mjedisin, por mbi të gjitha për shëndetin e qytetarëve. Drejtori që sapo foli u mundua që ta relativizojë apo minimizojë çështjen duke thënë: "Është thjesht një rinovim kontrate." Në fakt, nuk kemi të bëjmë me një rinovim kontrate, sepse marrëdhënia kontraktore e telefonisë celulare përkatëse me njësinë administrative Balldren dhe Dajç ka përfunduar respektivisht në vitet 2019 dhe 2020. Thënë ndryshe, kemi të bëjmë plotësisht me një marrëdhënie kontraktore të mundshme të re midis dy palëve. Por ndërkohë, lejen mjedisore, mbi bazën e së cilës ju pretendoni që të rinëshkruani një tjetër kontratë me këtë kompani celulare, ne kemi të vitit 2011. Pra, këtu e 15 vite më përpara është leja mjedisore, që do të thotë në atë kohë është studiuar, është analizuar që kjo infrastrukturë e telefonisë celulare është e padëmshme për banorët e zonave përkatëse, pasi rrezatimi nuk i dëmton ata, sepse ato zona posaçërisht kanë qenë të pabanueshme në atë kohë. Gjatë dëgjuesës publike, nga ana e banorëve të njësive administrative Balldren dhe Dajç, u pranua që infrastruktura e kësaj kompanie celulare në njësinë e Dajçit, në fshatin Dajç, është jo më larg se 500 metra larg nga zona e banuar, ndërkohë në fshatin Balldren është rreth 1000-1500 metra në distancë nga zona e banuar. Pra, lëvizjet demografike të banorëve në zona të caktuara kanë bërë që këto vendndodhje këtu e 15 vjet, pra nga 2011 e deri më sot, të jenë banuar nga qytetarët, e për pasojë rrezatimi i infrastrukturës së telefonisë celulare është pashmangshmërisht i dëmshëm. Edhe unë mendoj që ky projekt-vendim duhet të na shërbejë të gjithëve ne si pikënisje që të kërkojmë rishikimin e lejeve mjedisore të infrastrukturës së telefonive celulare, jo vetëm në Lezhë, por si pikënisje për rishikimin në nivel kombëtar, me qëllim që infrastruktura e telefonive celulare të zhvendoset sipas parashikimeve ligjore larg zonave të banuara, me qëllim që të shmangim rrezatimin e dëmshëm ndaj qytetarëve dhe mjedisit. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kryetari e ka fjalën.

-Pjerin Ndreu: Tani, jam dakord me shqetësimin, nuk kam ndonjë gjë për të thënë, por çështja e telefonisë celulare është një çështje e cila na afekton ne si njësi vendore për ta mbështetë si

shërbim normalisht. Dhe me këtë mënyrë, ne hapim rrugën, domethënë e mbështesim vazhdimin e një projekti i cili ka qenë. Këto aspektet teknike e pjesa e rrezikut nuk janë në kompetencën tonë për t'i shpjeguar. Ata që kanë dhënë licencën aty, ata që japin leje, kanë edhe leje mjedisore brenda. Megjithatë, ne japim vetëm pëlqimin, po do të jetë, s'do të jetë. Nëse ka diçka të rrezikshme aty, hajde të marrim një grup, t'i verifikojmë, gjejmë një, dy, tre problematika që duhet të riparohen dhe ia kërkojmë një zgjidhje, s'kemi pikë problemi. Ndërsa roli jonë këtu në këtë mes është thjesht dhënia e pëlqimit të vazhdimin. Edhe njëherë, nuk jemi ne kompetentë për të hulumtuar, ne mund të ngremë shqetësim, por jo gjithçka që thonë njerëzit atje, është ashtu si e thonë. Kam dëgjuar në këto dëgjesat publike lloj lloj fantazish. Ne nuk jemi për të diskutuar me marrë çfarë thonë të gjithë, por ne marrim si referencë gjërat që janë realisht problematike dhe realisht afektojnë negativisht apo pozitivisht komunitetin tonë. Në qoftë se ka diçka për të diskutuar, jam dakord që ne të ngremë një sistem vlerësimi të kushteve që ata duhet të plotësojnë në zbatim. S'jam kundra edhe për ta parë në kompleks gjënë. Por ne japim sot pëlqimin, do vazhdojmë ose jo. Do e heqim, do dalë njëri aty që do me dërgu SMS, s'ka valë, do na hapen telashe të tjera. Po unë mendoj që të japim pëlqimin, pastaj çdo shqetësim që s'kam pse i paragjykoj dhe nuk them që nuk kanë të drejtë, ne t'i vlerësojmë në një mënyrë tjetër dhe e kemi në dorë.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Vetëm për të shtuar diçka, siç tha edhe kryetari, nuk është se jemi kundra shqetësimeve, por thjesht në lidhje me lejen mjedisore dhe për shkak të asaj që tha që duhet t'i përmbahemi ligjit. Dakord, leja mjedisore mund të ketë këtu e 15 vite përpara, por nuk besoj që ka një afat kohor të përcaktuar dhe fakti që nuk ka një afat kohor të përcaktuar, nuk e bën të pavlefshëm. Kështu që nuk mendoj që kemi arsye të heqim një shërbim, patjetër të ngrihet një komision, siç tha kryetari, përderisa ky shërbim sjell dhe ca taksa, ca të ardhura, mendoj që ta shikojmë me kujdes, për momentin ta kalojmë, pastaj ngremë dhe grupin nëse ka shqetësim që duhet marrë parasysh. Faleminderit.

-Ka dalë këshilltari Aleksander Mekaj.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër? Dua të shtoj diçka në lidhje me projekt-vendimin. Në dëgjesën publike që u zhvillu në njësitë administrative respektive, që thamë pak më sipër, kryetarët e fshatrave, madje i Mabës, ngriti problemin se në qoftë se ato antena nuk do të ekzistojnë, ne s'kemi valë celulare fare. Pra, del një kontraditë tjetër, sikur ne sot t'i heqim ato antena, sikur të kemi forcën tonë për t'i heqë fare, do të dalim vërtet, mund të themi, të përballemi me komunitetin, sepse ndërpritet për gjithë fushën, si me thënë, qendrore të Zadrimes. Këtë kisha, pasi u tha dhe nga kryetari i fshatit, por edhe banorët që ishin aty.

Fjalën e ka zoti Marku.

-Agostin Marku: Faleminderit. Unë në parim jam dakord se duhet ky shërbim dhe duhet sa më afër qytetarëve. Por pikësëpari për ne është shumë e rëndësishme shëndeti i njerëzve. Dhe është detyra jonë, kur marrim një vendim të tillë, ta dimë edhe sa ndikojnë në territorin që janë vendosur këto antena, sa ndikojnë në problemet shëndetësore tek njerëzit, sepse i dimë efektet që kanë. Dhe kjo ka të bëjë edhe me atë lejen mjedisore, edhe ka të bëjë edhe me shumë faktorë të

tjerë. Por përveçse duhet t'ia ofrojmë këtë shërbim, që pa diskutim që duhet t'ia ofrojmë, duhet të insistojmë, qoftë edhe me atë grupin e punës, apo me një komision, apo me çështje të tjera, që kompania të realizojë të gjitha standardet që i takon për sa i përket problemeve të tjera që ndikojnë në mjedis, që ndikojnë edhe në shëndetin e njerëzve. Gjithashtu, do të ishte pozitive ta dinim në këtë kontratë që kishte kjo kompani me njësitë vendore, se me bashkinë s'e ka bërë ndonjëherë, por me ish-komunat, çfarë leverdie financiare ka pasur bashkia deri më sot dhe sa do të ndikojë edhe për të ardhmen, sepse dihet, aty ku ka një shfrytëzim të zones, të gjitha këto e bëjnë shumë të domosdoshme që të jetë një raport më i hollësishëm në të ardhmen dhe në radhë të parë, në krye të raportit të jetë sa ndikon në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve. Në parim jam dakord që ta kalojmë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka të tjetër? Atëherë, kush është dakord me projekt-vendimin? Ju lutem, kartonat. 20 këshilltarë janë Pro. Këshilltarët Alfrida Marku, Rrok Marku, Tonin Jaku, Gjon Marku votuan Kundër, 4 vota Kundër. Ky projekt-vendim nuk miratohet sepse duhen 25 vota Pro.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, pika 7, Projekt-vendim "Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK". Nga asetet e bashkisë, kush do na sqarojë në lidhje me projekt-vendimin? Po zoti Pjetri.

-U kthye këshilltari Aleksander Mekaj.

-Artur Pjetri: Përshëndetje të gjithëve. Këto janë procedura që qytetari ka dorëzuar kërkesën për përfundimin e privatizimit të apartamentit, të cilat janë ndarë nga ish-ndërmarrja komunale e asaj kohe. Për arsye ose për një tjetër, qytetari nuk i ka vazhduar procedurat dhe i kërkojmë këshillit që ta kalojë.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka kush diçka në lidhje me projekt-vendimin? Atëherë, kush është dakord? Ju lutem kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 8, Projekt-vendim "Për shitjen në ankand për skrap të mjeteve të dala jashtë përdorimit". Në lidhje me këtë, nga drejtoria e shërbimeve do të na sqarojë drejtori. Faleminderit.

-Jurgen Marku: Përshëndetje. Kemi një projekt-vendim për sa i përket shitjes në ankand të disa mjeteve që janë akumuluar nga bashkia dhe nga ish-komunat. Praktikisht janë tre autovetura, dy zjarrfikëse, një autobus, dy ekskavatorë, një kamionçinë dhe një fadromë, mjete të cilat nuk janë në gjendje pune. Këto mjete, aktualisht magazinohen pranë magazinave të bashkisë së Lezhës, por për lirim të kësaj hapësire kërkohet heqja, shitja e këtyre mjeteve.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush ka diçka në lidhje me projekt-vendimin? Zonja Gjoni.

-Flutura Gjoni: Po, kisha një pyetje. Ku jeni bazuar për të vendosur çmimin 16.033 lekë për litër. Se me ç'pashë unë nga relacioni që na keni bërë bashkëlidhur, keni bërë një studim të tregut, keni bërë një mesatare të thjeshtë. Për ankandet nuk ka mesatare të thjeshtë. Për ankandet as nuk studiohet tregu bile. Domethënë, kërkohet oferta dhe oferta më e lartë shërben si ofertë fillestare për ankandin.

-Jurgen Marku: Atëherë, janë marrë çmimet e referencës sipas studimit të tregut dhe nëpërmjet këtij çmimi nis çmimi dysHEME i ankandit.

-Flutura Gjoni: Jo, jo, jo, për ankandet çmimi më i lartë shërben si çmim fillestar.

-Jurgen Marku: Është marrë me mesatare të thjeshtë.

-Flutura Gjoni: Nuk ka ankand me mesatare të thjeshtë. Prandaj thuhet ankand, kush jep më shumë. Jam dakord me heqjen, me lirimin e vendit e me të gjitha këto, por procedura...

-Jurgen Marku: Po, por kjo procedurë duhet të hidhet në ankand.

-Ndue Luli: Atëherë, fjalën e ka zoti Marku për një sqarim.

-Agostin Marku: Ne sot nuk hyjmë te procedura e ankandit. Ne sot japim miratimin që t'i heqim. Ky çmimi që është sot, a nga studimi i tregut, a nga të dhënat e statistikave që dalin në buletinet etj etj, është një çmim referues. Pastaj edhe mund të rritet vlera e ankandit. Ne nuk kemi shkuar te ankandit. Ne thjesht në parim do i japim miratimin bashkisë që po, do të kalojë për skrap mbi bazën e gjithë procedurave që ka ndjekur bashkia, se nuk janë marrë në gjendje pune e tjera, e tjera, e tjera, dhe ato që tha, janë në magazinë. Por ato nuk mund të mbahen më. Dhe si të tilla, ne duhet të japim miratimin. Procedura, vlera, e tjera, si rritet, si ulet, si ashtu janë pas këtij vendimi. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka kryetari.

-Pjerin Ndreu: ta sqarojmë dhe njëherë këtë. Ka të drejtë Agostini. Tashi, se mund të luajmë mendsh ne në referenca, kjo është çështja e jonë, nuk është çështja e këshillit për momentin, për arsye se ne na duhet pëlqimi. Do i shesim, s`do i shesim, do i mbajmë aty, pastaj se ai i ka futur referencë që a është a s`është e saktë duhet parë. Dhe kur të hapet praktika, të paktën me sa kam dijeni unë, në të gjitha llojet e praktikave tona, ne nuk na është kapur ndonjë shkelje ndonjëherë. Kemi qenë shumë strikt në vlerësimin e gjërave. Para se me dalë, mund të bëhet një rikorrekim i asaj, se ne dhe ne s`kemi nxjerrë shifra anormale, ose të paqarta. Pra, shifra këtu nuk është për diskutim. Shifra është thjesht një referencë. Për mua, s`duhej ta kishte sjellë fare shifrën, s`ka lidhje shifra këtu. Ne marrim pëlqimin për nxjerrjen në ankand. Pastaj ankandit ka ato rregullat e veta se si bëhet.

-Ndue Luli: Zonja zv/kryetare.

-Brikena Vuksani: Në bazë të VKM-së për rregullat e ankandit publik, përcaktohet një vlerë fillestare. Kjo vlerë fillestare përcaktohet me një komision të posaçëm. Pikat ku duhet të përmbahemi për këto janë ose sipas INSTAT-it, ose sipas çmimit të tregut.

-Flutura Gjoni: Pika më e lartë shërben si referencë fillestare, këtu ka pa.

(Ka debat pa mikrofonta midis znj. Gjoni dhe z. Marku)

-Pjerin Ndreu: Nuk është çështje me e ba dramë se nuk po bëhet korrupsion me shit ato hekurat. Nëqoftëse ka ndonjë gjë, mund ta diskutojmë. Në ankand, njësia që e bën atë mban përgjegjësi ligjore në qoftë se e bën një x shkelje, pike, që nga i pari e deri te unë si titullar. Ne jemi të

kontrollueshëm, nuk jemi që e bëjmë në qejfin tonë gjithëka. Kontrollin e Shtetit e kemi aty sot që flasim tani, e kemi në bashki, ka një muj e ca, kanë zgatur dhe afatin. Pra, ne nuk jemi se i bëjmë gjërat në tym. Të kapim shifra e të themi jo kështu, jo ashtu. Se duket sikur jemi tu u fut në ca kalibra korrupsioni dhe ju jeni tu i kap. Për mua nuk është muhabet për debat ky. Madje unë e kam shty ka tre vjet e mezi u bëme gati. Edhe në një zyrë, kur i prishet një fotokopjues, një kompjuter, duhet bërë procesverbal për nxjerrje jashtë përdorimit, sepse është në inventar. Dhe janë gjëra që ne na kushtojnë aty. Ne mbajmë gjëra që kena në inventar. Nesër me thënë ku e ke ti këtë, e kam në fushë tu u kalb atje.

-Ndue Luli: Ka kush ndonjë gjë tjetër? Nuk ka. Kush është dakord me projekt-vendimin? Ju lutem kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 9, Projekt-vendim "Për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe kryetarëve të fshatrave në fshatrat ku kryetarët janë të emëruar nga Kryetari i Bashkisë".

Në projekt-vendim janë dhënë të gjithë fshatrat, janë dhënë datat përkatëse, komisionet nga këshilli, është dhënë dokumentacioni që do përdoret në zgjedhje, por duhet të shtoj këtu, kjo është për mangësinë tonë, kemi lënë një fshat pa hedhë aty, prandaj duhet të përfshijmë edhe fshatin Krajën, të Njësisë Administrative Blinisht, ku duke parë edhe kalendarin, që mos të kemi ndonjë karambol me datat, bëhet fjalë për me 17 shkurt me pasë zgjedhje në këtë fshat, me komisioner nga këshilli, Klejvi Hoxhiqi, Shtjefën Lleshi, Rrok Marku, Tonin Jaku. Pra, edhe njëherë, po përsëris, përveç projekt-vendimit që keni përpara, të shtojmë dhe këtë fshat, është për harrësë, jam i bindur se secili e kupton. Kush e do fjalën? Zoti kryetar, po.

-Pjerin Ndreu: Para se me diskutu, dua të bëj një sqarim. Është e treta herë që unë kërkoj këtu në këshill, që të bëhen zgjedhje. Këshilli, nuk e di, se është kompetenca juaj, nuk është kompetenca ime, por këshilli nuk ka qenë dakord. Unë mendoj se ka ardhur koha që ne mos të procedojmë më me as edhe një emërim të këtyre kryetarëve të fshatrave, për arsyen se krijohet një kaos në menaxhimin e problematikave atje. Ndoshta ndonjë emërim i joni nuk shkon në harmoni me mendimet e komunitetit aty ose me ato që mendojnë me votu ata. Dhe mua nuk më shkon fare, nuk dua me ditë absolutisht, po jua them publikisht, fare se i kujt partie është, e kush fiton, e kush s'fiton. As jam përzi, as merrem me ta. Kush ka qejf që të llojë për njërin, e kush ka dëshirë të llojë për tjetrin, e ka derën e hapur të llojë për kë të dojë. Historia ka treguar se në disa përplasje, ku në fakt kanë fitu të opozitës, më janë kthyer mua se pse s'më bëre ti mua kryetar fshati, kur ti s'je i zoti më marrë votat atje. Nga ana tjetër, mendoj se këshilli duhet të ketë rol më të fortë në këtë histori. Këshilltarët duhet të shkojnë njëherë atje. A vijnë, a s'vijnë njerëzit, ky është problem pastaj për t'u diskutuar. Nëse një, dy kandidatë, a tre kandidatë atje nuk janë të zotë me mbledhë njerëzit dhe me kriju kuorumin e nevojshëm, ky është problem pastaj që do hyjmë ne dhe e zgjidhim me emërim. Por duhet të bëhen njoftimet sipas ligjit, duhet të njoftohen shtëpi për shtëpi, duhet të gjendet edhe marrëdhënia me administratorët, duhet të jetë më e ngushtë që të bëhen njoftime shtëpi për shtëpi. A vijnë, a s'vijnë, edhe vetë kandidatët duhet të bëjnë punë që t'i bindin njerëzit që mendojnë se do i votojnë dhe të bëjnë shumicën. Pikë. Kaq e qartë është. Unë mendoj se kjo çështja e emërimit të disave është e dëmshme dhe për mua në funksionimin e përditshëm ka krijuar probleme dhe ka krijuar edhe përplasje madje dhe

brenda fiseve, brenda miqësive. Ne nuk duhet më të shkelim në një histori të cilën e vendosim ne nga zyra. Për të zgjedhur, ndryshoje ligjin dhe i zgjedh unë nga zyra të gjithë edhe them ti do jesh këtu, ti do jesh këtu, unë s'i njoh në katund atje. Pse unë do të vendos njerëzit nëpër katunde? Njerëzit nëpër katunde, as nuk me di se është i majtë, as nuk du me dit se është i djathtë, as nuk du me dit nga bie me shtëpi. A gëzon respekt nga komuniteti? A e votojnë ata? Për mua në rregull është, as s'kam diskutim. Përgjegjësinë për funksionimin e marrëdhënies me komunitetin i mban vetë ai, nuk i mbaj unë. Këshilli duhet t'i monitorojë herë pas here qasjen e kryetarëve të fshatrave që kanë në komunitet, se disa s'bëjnë asnjë punë fare, zero. Vetëm marrin atë pagesën dhe sillen vërdallë nëpër fshat, pa bërë zero punë. Dhe ne tashti do fillojmë, me datën 4, jeni të ftuar të gjithë për të filluar fushatën sensibilizuese për skemën e re të pastrimit. Pra, do të jetë një diskutim publik, për çdo njësi, dhe do të jenë kryetarët e fshatrave, ata që janë të ngarkuar drejtpërsëdrejti, bashkë me administratorët, në ndjekjen e kësaj detyre. Shqip muhabeti, që t'i hiqet prej dorë kryetarit të bashkisë e kujtudo në mënyrë preferenciale, apo me këto gjetjet e miqve poshtë e përpjetë dhe me këto ngatërresat, që imagjino me u marrë unë me ngatërresat e kryepelqve për me u zgjedh, është absurde. Kështu që votën, pikë. Të votohen. Nëse nuk bëhet pastaj kuorumi njëherë, dy herë, veprojmë ne, u pa puna, s'kemi ç'të bëjmë.

-Ndue Luli: Kush e do fjalën tjetër? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Në fakt, strukturat komunitare, përfshirë këto kryesitë e fshatrave dhe kryetarët e fshatrave, e jo vetëm, edhe strukturat komunitare në zonat urbane janë hallka ndërlihdhëse që ligji "Për vetëqeverisjes vendore", ua vë në dispozicion qytetarëve me qëllim zgjidhjen e problematikave, trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave në komunitet, pse jo, dhe adresimin e tyre në mënyrë të drejtë drejt institucioneve përkatëse. Nëse lexojmë ligjin "Për vetëqeverisjen vendore", ai është drejtpërdrejt pushtet, jo pushtet, autoritet dhe përgjegjësi e këshillave bashkiakë. Kështu që krahas finalizimit të procesit të zgjedhjes së kryesive dhe kryetarëve të fshatrave, pse jo, në legjislaturat e tjera, një mënyrë më të mirë, pra me një përfshirje më të lartë të banorëve, unë mendoj që, siç edhe e kam trajtuar dhe në mbledhje të tjera, por edhe dje gjatë mbledhjes së komisioneve, u diskutua që tashmë ka ardhur koha që ne si këshill bashkiak të udhëheqim një tjetër proces shumë të rëndësishëm, që është zgjedhja e administratorëve të pallateve dhe e strukturave të tjera ndërlihdhëse komunitare në zonat urbane. Është diçka, një problematikë e evidente, e përditshme dhe që do të ishte në nderin tonë, po them, nëse ne japim gjithsecili kontributin tonë maksimalisht për t'i dhënë zgjidhje në shërbim të qytetarëve dhe zgjidhjeve të problematikave të shumta të përditshme. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Dua të shtoj diçka. Në lidhje me projekt-vendimin në fjalë, e para e punës duhet të dimë të gjithë se me marrjen e këtij vendimi nga ana jonë si këshill bashkiak, do të jemi të predispozuar, të gatshëm që ta realizojmë këtë proces tamam brenda rregullave që ka rregullorja e këshillit, në bazë të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore". Kështu që asnjë anëtar komisioni, ose më saktë mund të themi të gjithë anëtarët e komisioneve, duhet të jenë të gatshëm për datat dhe orët që do të përcaktohen nga njësitë administrative për zgjedhjen e kryetarëve dhe të anëtarëve të kryesive të fshatrave. Në lidhje me këtë problemin e fundit që e tha zonja Marku, unë e kisha ndërmend me fol te "Të ndryshme" dhe do ta lë për tek "Të ndryshme".

Atëherë, për projekt-vendimin në fjalë, në lidhje me zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, kush është dakord? Miratohet me 24 vota Pro. Këshilltarja Elsa Gazulli abstenoj. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 10, Projekt-vendim "Për pranimin si dhurim dhe vendosjen e statujës monumentale "Mbretëresha Teuta", ofruar nga fondacioni "Shqipëria Tjetër".

Nga drejtorja e kulturës, kemi profesorin Paulin Zefi.

-Paulin Zefi: Përshëndetje. Atëherë, flasim për dhuratë, pra është donacion, fondacioni "Shqipëria Tjetër", Marin Mema bashkë me donatorë, kryesisht shqiptarë të diasporës. Ideja e tij ka qenë fillimisht, që më u tregu sa më i sinqertë, për ta vendosur në Tiranë. S'e di arsyen pse s'kanë pranuar për ta vendosur në Tiranë. I jam lutur që ta sjellin në Lezhë, edhe e ka përqaftuar si ide. Kemi diskutuar direkt me kryetarin e bashkisë, Pjerin Ndreu. Ideja fillimisht ishte për ta vendosur këtu në lulishte. Kryetari tha mbingarkohet shumë lulishtja, edhe na sugjeroi idenë për tek ballkoni panoramik, te Rana e Hedhun, monument natyre dhe vendi më i përsosur i mundshëm. Atëherë, u desh prapë për t'i mbushur mendjen Marinit për ta vendosur aty, se kishte frikën se është larg zonave të banuara e mund të ndodhë ndonjë incident o diçka, edhe mund të ndodhi, se kanë ndodhur raste të tjera, edhe u ra dakord që të vendosej aty. Është prej bronzit, lartësia është 3.70 m, figura ose shtatorja, në total i gjithë monumenti bashkë me heshtën është 5.45 m. Kam hedhur idenë që edhe piedestali ose bazamenti të jetë i lartë mbi 2 metra, në mënyrë që shtatorja të kapë lartësinë rreth 8 metra. Vendi që kemi përzgjedhur, që e kam hedhë si ide, pasi na dha kryetari sugjerim për ta vendosur këtu, është ai rrethi bosh që kemi lënë. I kam thënë Jurgenit mos mbill pemë njëherë, se kemi një gjë shumë më të madhe, edhe do ta vendosim aty në pjesën perëndimore të ballkonit panoramik. Pamja do të jetë nga perëndimi, edhe nuk është kontraditë që pra është përballë diellit, del perfekt. Po ashtu, pamja nga të gjitha anët e tjera është me të vërtetë e përsosur. I qëndron edhe historikisht më shumë se gjithçkaje tjetër, përveç pozicionit natyror. Pse? Sepse bërthama e shtetit të mbretërisë ilire të ardianëve, është pikërisht kjo zonë. Kryeqytet ka qenë Shkodra, si qendër e dytë ka qenë Lezha. Vendlindja e Teutës është Bizon, në gjirin e Kotorrit, ndodhet mes qyteteve Shkodër, Lezhë, Ulqin, edhe Durrës dhe Shëngjin, përballë detit, kuptohet se baza kryesore e ushtrisë ilire, dhe për çfarë shquhet Teuta ka qenë flota e famshme ilire, me lembat e saj ushtarake, që sundoi detin Adriatik dhe pjesën lindore të Jonit, është vendi më i përshatshëm i mundshëm. Nqs keni ndonjë pyetje, me kënaqësi.

-Ndue Luli: Faleminderit për sqarimet që bëtë. Ka kush ndonjë gjë tjetër? Po, zonja Haxhia.

-Donika Haxhia: Përshëndetje. Në fakt, e sqaroi shumë bukur Paulini, edhe okej, po patjetër që jam shumë dakord. Ajo krijon një pikë referimi vizuale që ndikon shumë te identiteti kulturor i një qyteti, dhe më pas edhe ai historik. Janë një numër turistësh që kërkojnë edhe këtë përvojën autentike, dhe Paulini e sqaroi shumë bukur dhe e komplimentoj. Një pikë autentike, dhe unë në momentin kur e lexova, thashë ballkoni i mbretëreshës. Këto janë pika që me të vërtetë ndikojnë shumë në turizmin e një qyteti, sidomos Lezha, që këtë kemi pikë të fortë. Tani, dhe nuk dua që të më kundërshtojë dhe të më thotë mos u fut këtu, se është tek të tjera, sepse unë e shoh si lidhje, domethënë këtë. Kur atë e quajta dhe sinqerisht më pëlqen ballkoni i mbretëreshës, e kërkoja,

nuk e gjeta, po besoj që do të jetë e bukur. Nuk arrita ta gjej në internet, por gjithsesi do të jetë e bukur.

Nëse flasim ne për përvoja autentike, kemi urën e Cenit. Kur u prish ura e Cenit tani, edhe emërtimet në një qytet turistik janë shumë të rëndësishme, dhe njerëzit gjënë e parë që kërkojnë, o ku është kjo? Domethënë, ku është? S'e kam gjë Cenin, s'kam konflikt interesi. Kur u prish ura e Cenit, nuk e di se kush e kishte shkruajtur dhe s'dua të gënjej tani, a të them diçka gabim, kam lexuar diku një artikull, u prish ura e turpit. Personalisht, fjala urë është një ndër më të bukurat e gjuhës shqipe për konotacionin që mban, për peshën semantike, dhe s'mund ta quash kurrsesi një urë, ura e turpit. U vu ajo ura e drurit, e shkurtër, shumë e bukur. Më pëlqente sa herë kaloja te ajo që i ndihmoja edhe qytetarët, por nuk them pse u prish ura, sepse janë ata studiuesit, ajo do të jetë bërë për t'u prishur, ndoshta ishte ku di unë, gjërat teknike, unë s'do futem aty. Por do isha kurioze njëherë, ajo që e kishte shkruajtur atë urën e turpit, si do t'i dukej kjo urë e re që është ndërtuar? Unë jam për përvoja autentike. Nuk është e bukur, vëlla. Mund të jetë më e fortë. Mund të jetë më e fortë. Nuk dua të futem fare aty. Ato hekurat në anësore njëherë nuk përshtaten fare me një qytet turistik, që ajo urë ty të lidh me lagjen më të bukur dhe më turistike, se kemi ishullin. Dhe tani, te lagjja e hotelit, do shkosh, do futesh te ura e Cenit. Mua, kur e kam parë atë ditë, më është dukur sikur ishte shkëputur një copë nga autostrada, dhe ishte hedh aty me ato hekurat. Nuk janë për një urë. Duhet një, nuk e di, nga fondi i zhvillimit, nuk di sa ka qenë fondi, e tjerë, e tjerë, por mendoj që është në nderin e qytetit tonë, të ishte më e bukur. Edhe kur zbret, se unë zbres përditë aty. Ndoshta s'kanë mbaruar, nuk e di, ndoshta do ketë ndonjë ndërhyrje tjetër. Kur zbret kështu, nuk zbret drejt, po zbret kështu pjerrtas. Domethënë, karrocën duhet ta mbash kështu, edhe një person i vetëm nuk ecën dot drejt. Do të jetë detyrimisht kështu. Pra, unë nuk di cili inxhinier e ka projektuar, thashë, s'do futem në gjëra teknike, po tek ajo ana estetike, le t'ia ruajmë atë bukurinë. Mund të bëhet një ndërhyrje, sinqerisht kisha mendu që do bëhej diçka interesante, diçka që do të binte në sy, ngaqë lidh qytetin, hyhet dhe dilet nga qyteti. Faleminderit.

-Ndue Luli: Atëherë e the edhe vetë zonja këshilltare, se mund të bëhej dhe te "Të ndryshme", mirë që e kupton dhe vetë. Në lidhje me këtë, fjalën e ka kryetari.

-Pjerin Ndreu: Meqë e fillove me këto zhargonet e fejsbuqeve, unë s'e kam parë këtë - ura e turpit, unë s'e kam shkuar. Tashi, këtë punën e emrit, ura e Cenit, i ka ngelur ura e Cenit. Ndaj, ia vëmë me këshill si të doni ju. S'na prish asnjë gjë, po ajo ka ngel si simbol, ura e Cenit dhe ura e Cenit kemi thënë edhe ne. Tani, e para e punës, ajo urë ka pasur problemin më të madh ndër të gjithë, kalim këmbësorësh. Dhe e dyta, ura ka qenë e amortizuar. Kam pa unë, kam ndjekur dhe disa komente që ne e kishim vjedhur. Ne s'kemi prokuruar fare, mirë që e di se është e Fondit të Zhvillimit.

Ne kemi për detyrë për të drejtën o zysh se je këshilltare, të drejtën ia ke borxh këtij këshilli, edhe atyre që të kanë zgjedhur. Ajo urë ka qenë e amortizuar, përveç se ka qenë e papërshtatshme për zhvillimin dhe të ardhmen, sepse njerëzit dhe makinat kalonin në të njëjtin vend. Vetëm aq mjafton për të thënë se është bërë ura më e bukur në botë, se kalojnë njerëzit rehat. Tani, që ai projekt mund të ishte me ndonjë nga këto urat fantastike, edhe mund të ishte, po ne kemi synuar një rrugë funksionale që të krijojë lehtësira për njerëzit dhe për makina. Ajo

nuk është një urë e asaj tipologjie që ne mund ta zbukurojmë, po dhe mund t'i vëmë, po edhe nuk është ndonjë hata dhe mos t'i vëmë.

Nuk ka asnjë lloj gjëje të keqe. Në atë lagje, sikur keni thënë ju, kena heqë ujin komplet, Pra, të gjithë atë lagje ne e kemi rikualifikuar. Ne akoma s'e kemi marrë në dorëzim urën.

Në qoftë se ka ndonjë gjë që duhet të riparuar, është tjetër gjë, por kjo nuk e zhvlerëson rëndësinë e asaj që ka sjellë ajo urë.

Me ngrit një grup zv/kryetari sot, me shkru me verifiku dhe njëherë në detaje, të gjitha ato që thotë zonja këshilltare, dhe ne jemi absolutisht po, pse jo, s'ka asnjë lloj problemi.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Artan.

-Artan Ndreu: Atëherë, përshëndetje të gjithëve, unë kam një kërkesë zoti kryetar i bashkisë, se ne kemi një djalë, drejtor atje historian e hulumtues e ça nuk është, dhe kam shumë qejf ta respektojmë, se është i parespektuar në Lezhë, është një ndër të paktët në Shqipëri.

-Pjerin Ndreu: Tashti, e para unë kam konflikt interesi se e kam kushëri që ta dish, dhe nuk më lejohet me folë.

-Ndue Luli: Keni një gjë tjetër, zoti Artan?

-Artan Ndreu: Po, po, shumë herë kam qejf me fol, po ka thënë një fjalë zysha, se këtu ka njerëz që duan me kap prime-n. Është djalë i rrallë në Shqipëri, zoti Paulin Zefi, seriozisht, mendoj ta vlerësojmë.

-Ndue Luli: Faleminderit, fjalën e ka zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Unë doja të thoja diçka lidhur me urën, po meqë e hapi zysha, po them diçka si inxhinier për ta përmbledhur atë që tha zysha. Nga ana konstruktive patjetër që është bërë puna më mirë, nga ana funksionale, po e po, sepse kam dëgjuar dhe histori që po ajo u bë sikur ishte, sepse mendonin se do bëhej me katër korsi, po nuk arrij ta kuptoj si mund të bëhet një urë me katër korsi, kur dy rrugët hyrëse janë me dy, nejtë këto janë përralla. Por gjithsesi, ajo që doja të thoja si inxhinier, unë banoj në atë lagje dhe unë, dhe nuk janë gardrelat që janë vendosur tek ura të përshtatshme për një urë që është hyrja e qytetit. Gardrelat siç tha janë për në autostrada, superstrada. Prandaj mendoj që për atë që përfaqëson ajo urë, një parmak i cili mund të jetë në një arkitekturë më domethënëse që përkufizon tamam hyrjen.

-Pjerin Ndreu: Ne do ta bëjmë me fondet tona, veçse mbani mend në këtë sallë, lexoni komentet në Facebook dhe thonë: Vodhën lekët aty, i vodhën prapë edhe këtu, se këtë muzikë do kem unë, po do ta bëjmë, do të gjejmë një model të mirë, pak a shumë sikur e kemi bërë te ura Skënderbeg. Është një detaj që mua më ka shpëtuar në fakt, por që rregullohet, e bëjmë vetë.

Kemi një punë me tregun aty te lagjia jote (I drejtohet zonjës Haxhia), do të japim një rrugë atij tregut. O do bëhet treg i ri, o do hiqet prej aty, dy rrugë ka. Dhe unë u kam kërkuar atyre që merren me atë punë të më sjellin një projekt, një treg të atij lloji ne nuk kena për ta lënë më. Në fakt, bashkia nuk e menaxhon atë treg, edhe nuk di se çfarë marrëdhënie ka bashkia me tregun.

Unë s'e kam gjetur asnjë letër akoma, megjithatë ne kemi bërë një që ta dimë një hap kontrolli, s'mund të mbajmë një geto.

-Ndue Luli: Mirë, atëherë kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro.

Kalojmë tek dy projektvendimet e fundit dhe pas tyre tek informacionet.

Projektvendim "Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve dhe mësuesve dhe qendrave të grumbullimit". Ka kush ndonjë mendim? Zoti Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Përshëndetje të gjithëve. Edhe në kohën kur ka qenë me komunë, Shëgjini ka qenë pak problem, sidomos zona e Kunes kemi pasë vënë fugon, është heqë prapë dhe nuk ekziston.

-Ndue Luli: Tjetër mendim ka? Zoti Jaku.

-Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Në lidhje me transportin urban, unë kam një problem, sidomos te njësia administrative Shënkoll dhe kryesisht fshati Rrilë dhe bëhet fjalë për lagjen 13 Qershori. Është një lagje me rreth 10-15 familje që janë 5-6 nxënës a 10 nxënës. Edhe bëhet problem një ndalesë që nxënësit i ndalon në krahun e kundërt të autostradës dhe ata kalojnë autostradën gjithmonë në rrezik. Ne e kemi ngrit si problem edhe me drejtorinë arsimore dhe nuk i është dhënë zgjidhje. Është një kërkesë e banorëve me vite dhe nuk gjen zgjidhje. Ju lutem, këtë problem ta shikojmë, sepse fëmijët aty riskojnë duke traversuar rrugën. Këtë problem drejtoria përkatëse ta shikojë dhe të bëjë marrëveshje me kompaninë që e ka tenderin për transportin e fëmijëve dhe të shikohet mundësia e të lëvizet që ata nxënës mos ta kalojnë krahun e kundërt të autostradës. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Nga drejtoria e shërbimeve, sektori i transportit, ç'mund të na thoni në lidhje me mendimet që dhanë të dy këshilltarët?

-Jurgen Marku: Atëherë, përsa i përket ankesës së zotit Gjinkola, linjat miratohen nga zyra vendore e arsimit paruniversitar. Ne vetëm thjesht njoftojmë pjesën e distancave në kilometra sa përkojnë nga vend grumbullimi deri te shkolla për mësuesit e nxënësit. Ndërsa përsa i përket problematikës së ngritur nga zoti Jaku, për sa ka diçka teknike te pjesa e pozicionimit të mjetit nga një krah në një krah tjetër të rrugës, është diçka që do e shohim, do e vlerësojmë në terren dhe ta konkludojmë dhe me kompaninë.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka ndonjë mendim tjetër?

Do të sqaroj diçka unë, do jua mbështes mendimin kur të keni mendimin e drejtë patjetër. Duhet që njësitë administrative, në bashkëpunim edhe me drejtorinë përkatëse të shërbimeve, kur paraqiten këto projektvendime për të përcaktuar pikërisht në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të transportit të mësuesve dhe nxënësve, duhet studju së bashku dhe jo me e lënë vetëm thjesht, duke e marrë ndoshta shabllon edhe nga zyra arsimore dhe duke e sjellë tek drejtoria dhe direkt me e sjellë tek këshilli. Pra, duhet bërë një studim paraprak. Po zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Më falni për mosdijen e kësaj situatë, po e para është ashtu siç e tha drejtori i shërbimeve që ne nuk kemi rol parësor këtu, po drejtorja e arsimit duhet të ishte këtu sot me na sqaru. Se ne nuk jemi në gjendje për ta marrë përsipër një sistem të organizimit të tillë dhe nuk kemi detyrë të tillë. Po, ne edhe në planin e transportit që do nxjerrim tashti, do kontaktojmë një kompani kompetente për këtë punë për të na bërë një plan total të transportit në Lezhë, ku ne do ta rinovojmë komplet. Është një tjetër gjë, por në këtë histori duhet të hyjë edhe cilësia e automjeteve se kam pa ca ca mjete që transportojnë nxënësit që janë katastrofë. Katastrofë. Ky është një problem që ne duhet të ndërhyjmë patjetër. Për mua, duhet të jetë edhe drejtorja e arsimit këtu prezente, për shpjegime më të hollësishme për këtë lloj transporti që në fakt është delikat dhe ka ardhur koha që mos ta kalojmë kështu, hajde se e miratojmë. Unë propozoj që ta shtyjmë, të thërrasim dhe ata, të nxjerrim edhe disa problematika që kemi dhe të diskutojmë si t'i eliminojmë. Nuk bëhet shaka me fëmijët. Dakord?

-Ndue Luli: Po, zotë kryetar, një sqarim duhet të bëjmë para këshillit se ky është një projektvendim i cili si rregull duhet të ishte paraqitur nga zyra e arsimit të Lezhës që në muajin dhjetor, se bëhet fjalë për vitin 2026. Madje mund ta quajmë pak të vonuar, një muaj, kështu që po mos ta miratojmë sot të paktën, po edhe me ndryshimet që kemi të drejtë t'i bëjmë ne së bashku, ndikon për keq në lidhje me pagesën e transportit. Kështu që mendojmë që të fusim, mund të themi atë pikë që i takon pikërisht që ka të bëjë me rritjen e shërbimit për nxënësit dhe mësuesit.

-Pjerin Ndreu: Që të bëjmë një sqarim, në këshill ata vijnë, janë të detyruar me ardhë, në qoftë se këshilli merr vendim që të vijë arsimit, merr vendim që të vijë policia e shtetit që japë informacion për gjendjen e rendit e qetësisë, të vijë spitali për gjendjen e shëndetësisë. Të gjithë institucionet janë të detyruar me ardhë në këshill dhe me dhënë para gjithë këshilltarëve informacion. Ne nuk i tregojmë se çfarë pune do bëni, si do e bëni, por nëse i identifikojmë një, dy, tre, pesë probleme që nuk shkojnë, ne do mbajmë qëndrim. Edhe ne si bashki kemi interes që roli i këshillit të rritet në këtë drejtim, të jetë më shumë aktiv dhe të jetë më shumë vlerësues edhe për institucionet e tjera. Ka institucione të cilat nuk e bëjnë punën ashtu si duhet, ose bëjnë sikur e bëjnë punën si duhet, por kur hyn në brendësi pastaj, sheh të tjera gjëra. Kështu që unë i kërkoj këshillit që të jetë më aktiv në këtë drejtim.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Marku.

-Agostin Marku: Tani, drejtorja arsimit vjen tek ne duke u bazuar në vendimin e qeverisë, ku është vendimi i qeverisë që subvencionon. Në qoftë se është poshtë kilometrave që e përcakton vendimi i qeverisë, ajo s'ka si ta sjellë tek ne. Ajo thotë: "Më jep kilometrat për këto distanca të cilat subvencionohen sipas vendimit të qeverisë." Dhe ne këtë po bëjmë. Çështja e shërbimit, çështja e se si janë mjetet, e tjera, e tjera, ato hyjnë te kontratat që kanë për të detyrimet, por kjo s'na ndalon ne që t'i thërrasim në raport se si kryhet shërbimi. Por sot nuk është kjo çështje në vendimmarrje. Sot është thjesht largësia mes atyre zonave ku është e përcaktuar që do subvencionohet çështja e transportit të fëmijëve, edhe të mësuesve. Faleminderit.

-Ndue Luli: Ka mendim tjetër? Atëherë, kush është dakord me projektvendimin, mendoj, duke shtuar në vendimin që do të marrim edhe mendimet e këtyre këshilltarëve, i cili është mendim në

dobi të transportit të mësuesve dhe të nxënësve. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 25 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë tek projektvendimi i fundit “Për miratimin e programit për zhvillimin e aktiviteteve për pritje e përcjellje zyrtare për vitin 2026”. Në lidhje me këtë projektvendim, fjalën e ka zv/kryetarja e bashkisë.

-U largua këshilltari Gjon Marku.

-Brikena Vuksani: Ky është një projektvendim dhe në zbatim të buxhetit të vitit 2026, ku janë parashikuar shpenzime për pritje e përcjellje për delegacionet e huaja, për administratën e bashkisë dhe për kabinetin e kryetarit. Në bazë të vendimit të këshillit të ministrave që është për shpenzimet për pritjen dhe përcjelljen e delegacioneve, miratohet edhe programi i zhvillimit të aktiviteteve që do të jenë gjatë të vitit 2026, ku presim që të ketë pjesëmarrje të delegacioneve apo të personaliteteve të huaja. Bashkëngjitur janë edhe aktivitetet që do të zhvillohen.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën tjetër?

-Donika Haxhia: Ndoshta me iu ndryshu vendet në renditje, që të jetë kronologjike.

-Ndue Luli: Atëherë, kush është dakord me projektvendimin duke bërë atë ndryshimin teknik? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 24 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë atëherë tek informacioni i parë, Informacion nga Drejtoria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a. Lezhë. Tani, të gjithë kemi marrë materialin. Drejtoria përkatëse mund të japë informacionin mirë dhe pastaj t'u përgjigjet pyetjeve dhe problematikave që kanë këshilltarët. Fjala për ju, drejtor, vetëm pasqyrat financiare mund të sqaroni.

-Zef Maçi: I nderuar kryetar i këshillit, të nderuar këshilltarë, i nderuar kryetar i bashkisë, përshëndetje të gjithëve.

Ju falenderoj dhe jemi të vlerësuar që po na bëni të mundur që në këshillin e bashkisë, t'ju japim informacion mbi punën dhe veprimtarinë e shoqërisë ujësjellës kanalizime Lezhë, dhe posaçërisht njësisë së shërbimit të Lezhës, për ose në funksion të përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Tani, ju ma kushtëzuat këtë informacion, se kisha qejf që ta trajtoja komplet materialin.

-Ndue Luli: Më fal drejtor, të lutem. Është puna se materiali juaj ka ardhur në datën e caktuar sipas njoftimit që është bërë dhe jeni treguar korrekt në këtë dhe u është dërguar gjithë këshilltarëve dhe them që janë të njohur me informacionin këshilltarët, kështu që vetëm në lidhje me pasqyrat financiare që ka shoqëria juaj, mund të na informoni, kurse pastaj këshilltarët mund të kenë problematika për të cilat ju do jepni përgjigje.

-Zef Maçi: Në funksion të veprimtarisë të administrimit dhe të menaxhimit, vijon dhe tematika e përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimit të treguesve të performancës në vazhdimësi të vendosur nga qeveria shqiptare dhe donatorët e investitorët e huaj.

Por me qenë se ju ma kushtëzoni që unë të merrem me tabelën financiare, sigurisht që po kaloj te tabela. Po vazhdojmë me treguesit ekonomikë financiarë për vitet 2024 dhe 2025, që e përsërita që vijnë në funksion të menaxhimit dhe të administrimit të kompanisë.

Zhvillimi i aktivitetit financiar, njësia e shërbimit Lezhë, pra, unë nuk jam futur te shoqëria rajonale e ujësjellës kanalizimeve, duke mos u marrë me njësinë e shërbimit Kurbin dhe njësinë e shërbimit Mirditë, por kemi nxjerrë siç e keni kërkuar dhe ju vetë, treguesit ekonomikë dhe financiarë për vitet 2024-2025 për njësinë e shërbimit Lezhë.

Atëherë, të ardhurat e faturuara janë 296,018 lekë. Të ardhurat janë në mijë lekë për vitin 2024. Për 2025 janë 309,101 të ardhura në mijë lekë. Të ardhura të arkëtuara 304,336 për vitin 2024. Pra, të ardhurat e arkëtuara janë më të larta se të ardhurat e faturuara. Të ardhurat e arkëtuara për vitin 2025 janë 319,600 lekë. Gjithnjë në mijë lekë.

Kostot. Kostot operative përbëjnë paga sigurimesh shoqërore, materiale, energji elektrike, shpenzime të tjera, principiale interesa dhe kredi, shuma gjithsej dhe diferenca.

Pagat dhe sigurimet shoqërore janë 104,383 për vitin 2024. Për vitin 2025 janë 102,438.

Materiale 11,379 për vitin 2024, shpenzime materiale pra. Dhe për vitin 2025 janë 11,720 shpenzime materiale. Është një zë shumë i rëndësishëm, i cili tregon menaxhimin, funksionimin, administrimin, kujdesin dhe përdorimin e të ardhurave të ujësjellës kanalizimeve të Lezhës. Pra, për vitin 2024, ujësjellës kanalizimeve Lezhë e ka zhvilluar veprimtarinë e saj për materiale, pra shpenzimet direkte me 11 mln lekë. 11 mln lekë i harxhon një familjeve në vit. Dhe këto për arsye të kushtëzimit të fondeve të vëna në dispozicion, të shlyerjes së kredive, të shlyerjes së sigurimeve shoqërore, të ardhurave dhe në funksion të buxhetit të miratuar në qeveri.

Energjia elektrike. Energjia elektrike përbën zërin e dytë thelbësor të shpenzimeve të kostos direkte të operimit, pasi është furnitor jetik, ose që varet zhvillimi i aktivitetit dhe veprimtaria e shoqërisë ujësjellës kanalizime të Lezhës. Pasi shoqëria rajonale e ujësjellës kanalizime të Lezhës ndodhet në kuota plus minus 2 mbi nivelin e detit dhe ka në dispozicion 25 stacione pompimi, të cilat të gjitha funksionojnë me energji elektrike. Sepse uji i pijshëm nxirret në kuotat plus minus 64 metra nën nivelin e detit, pra nën tokë, në stacionen e pompimit. Ashtu siç janë në proces, përveç këtyre 25 stacioneve pompimi dhe 6 stacioneve të tjera pompimi, që janë 3 stacione pompimi në Shënkoll, pjesa që ndërtohet Mërq Rraboshtë dhe në Dajç.

Shpenzime të tjera operative 11,712. Për shpenzimet e tjera, anë 11 milionë lekë të reja, ose 110 milionë lekë të vjetra. Të tjerat janë shpenzime të domosdoshme.

Principali i interesave të kredive. Tani, ky është një zë tjetër shumë i rëndësishëm. Ujësjellës Kanalizime Lezhë është ndodhur vazhdimisht nën kujdesin e qeverisë shqiptare dhe donatorëve e institucioneve të huaja për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm në qytetin e Lezhës, që një kontribut shumë të rëndësishëm me mbështetjen dhe përkrahjen e kryetarit të bashkisë Lezhë, zotit Pjerin Ndreu. Kështu që ne kemi përfituar disa projekte me Bankën Gjermane për Zhvillim, me Bankën Europiane për Zhvillim, ku së pari është ndërtu ujësjellësi i Lezhës, një projekt strategjik, i pashoq në Republikën e Shqipërisë dhe ndër më të mirët në rajon, që për 9 vite nuk është prerë funksioni i furnizimit me ujë të pijshëm në Lezhë, energji pa energji, defekte pa

defekte, të gjitha janë llogaritë me praktikat më të rrepta inxhinierike dhe ka patur një sukses të plotë dhe shumë të rëndësishëm.

Dhe një gjë tjetër shumë e rëndësishme, në qoftë se menaxhimi i ujësjellës kanalizime Lezhë do të jetë në startin e nevojshëm inxhinierik dhe teknik, për 20 vitet e fundit, Lezha është e garantuar për furnizimin 24 orë me ujë të pijshëm.

Tjetër, në funksion të kësaj, pra, sigurisht që këto investime janë grant dhe kredi. Dhe një tjetër grant dhe kredi që është, është impianti i përpunimit të ujërave të ndotura, që është dhënë nga Banka Europiane për Zhvillim. Sigurisht dhe kjo ka interesa.

Ne, Ujësjellësi i Lezhës, si askush në Republikën e Shqipërisë, i shlyejmë të gjitha kreditë muaj për muaj dhe të gjitha interesat e kredive. Dhe kjo ka bërë që qeveria shqiptare, donatorët, ta rikonsiderojnë qytetin e Lezhës, duke sjellë 16 milionë euro investim për eliminimin e përmbajtjeve në qytetin e Lezhës, një herë e mirë, për ndërtimin e ujësjellësit Kodër Marlekaj, Gocaj Kakarriq dhe magjistralin kryesor të ujësjellësit në Shëngjin.

Dhe përsëri, nuk është për të qeshur, është shumë serioze, është e vërtetë dhe duhet të thuhet, dhe e them gjithmonë që ka qenë dhe kontribut shumë i madh mbështetja e kryetarit të bashkisë, zotit Pjerin Ndreu. Nuk janë këto fjalë, po ato që duhen thënë, duhen thënë.

Për sa i përket interesave të kredive, këto interesa kredish janë shlyer pra të gjitha, dhe është rikoncedu përsëri ky projekt.

Një tjetër sihariq për këshillin bashkiak. Me 16 deri me 19 shtator të vitit 2025 janë miratuar për bashkinë e Lezhës, për qytetin e Lezhës, investimet për impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura, i cili do të rikonsiderohet plotësisht, për sa i përket anës, jo vetëm funksionale, por do të dyfishohet dhe do të përmirësohet teknologjia, duke kaluar në standarde të Bashkimit Europian. Gjithashtu, në këto fonde, të cilat janë të Bankës Gjermane për zhvillim, por edhe BAEF-it, pra të Bankës Evropiane për Zhvillim për Ballkanin Perëndimor, do të konsiderohet dhe magjistrali kryesor i ujësjellësit Shëngjin dhe rrjeti shpërndarës i saj.

Prandaj shlyerja e këtyre kredive ka bërë që ato investime të vazhdojnë, investime këto, kapitale strategjike.

Mbulimet e kostos, diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, është 12,522 për 2024 dhe 11,869 për vitin 2025. Për të shlyer këtu amortizimin, këto janë, këto janë të ardhura e shpenzime për koston direkte të operimit. Pra, përputhet plotësisht dhe thashë se këto tregues financiarë mbulohen me shumë sakrificë dhe një punë të përkushtuar, të pakufizuar ndër vite, në mënyrë që të plotësohen kushtet për vazhdimin e investimit.

Të bëj edhe një sqarim të vogël për kreditë. Kreditë nuk i merr Ujësjellës Kanalizime Lezhë, i merr qeveria shqiptare, si garant. Ndërsa me marrëveshje nënhuaje, ne ia paguajmë shtetit shqiptar. Për financimet që bëhen për projektet nga donatorët dhe investitorët e huaj, operatorët hyjnë direkt nga banka gjermane për zhvillim në Frankfurt. Unë nuk po zgjatem me tej.

-Ndue Luli: Okej, atëherë fjalën e ka zoti Artan, pastaj zoti Ndreca, zoti Jaku e me radhë.

-Artan Ndreu: Atëherë, përshëndetje zoti drejtor, kam dy pyetje. Radhën e kaluar na keni bërë një kërkesë për rritje çmimi dhe në mënyrë unanime kena votu kundër rritjes së çmimit. Çmimi është rrit. Pra, pse na bie kërkesë, kur nuk na pyet kush? E para, e dyta, këtu thuhet se nga banka gjermane, ju keni marrë kredi, se nuk e kaam të qartë, a është investim i bankës gjermane apo është i kredisë ky investim?

-Ndue Luli: Do vazhdojmë direkt të japim përgjigje në mënyrë që, duke u dhënë përgjigje pyetjeve të njërit këshilltar, mund të ezaurohen edhe për ndonjë tjetër që mund ta ketë.

-Zef Maçi: Faleminderit. Rritja e çmimit të ujit në vitin 2024, sigurisht që këshilli bashkiak ka marrë vendimin, të treja këshillat bashkiake, për mosrritjen e tarifave të ujit. Por rritja e tarifave të ujit kushtëzohet nga ligji për Entin Rregullator të Ujit dhe ajo i merr në konsideratë çdo vit, e merr në konsideratë rritjen e tarifave të çmimit të ujit, pra vendos Enti Rregullator. Kjo ka ardhur për shkak të rritjes së pagës minimale nga qeveria shqiptare për mbulimin e kostove, për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë. Sigurisht, çmimi i ujit të pijshëm është rritë dhe një gjë tjetër shumë e rëndësishme, çmimi i ujit për bashkinë e Lezhës nuk është rritë që në vitin 2013, pra ka 12 vjet që s'është rritë çmimi i ujit. Në vitin 2024 janë rritë 7 lekë për konsumatorët familjarë, pra 12%, klientë publikë e privatë zero, klientët familjarë për ujrat e ndotura është rrit një lek, për klientë publikë është rritë tre lekë dhe për klientët privatë është rrit dy lekë. Në një kohë që ne në fakt kemi kërkuar unifikimin e tarifave në tre qytete, por Enti Rregullator nuk e ka unifiku, kurse pjesa tjetër është rritë në 50 e ca % në qytetin e Laçit dhe qytetin e Mirditës. Unë u mundova me sqaru problemin e kredive. Këto investime u mbështetën nga qeveria shqiptare. Dhe kreditë merren garant nga qeveria shqiptare. Nuk i marrin ne kreditë. 73% janë grant, falas pra dhe pjesa tjetër është kredi. Pra, i merr qeveria shqiptare, ministria e financave. Ne na ngarkon qeveria, ministria e financave në marrëveshjen e nënshkruar për shlyerjen e kredive si Ujësjellës Kanalizime Lezhë.

Nuk investojmë ne. Ne jemi ndërmarrje shërbimesh.

-Ndue Luli: Atëherë vazhdojmë përsëri me pyetjet. Zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Duke përfitur nga rasti që kemi të pranishëm drejtorin e një ndër institucioneve më të rëndësishme dhe më jetike për qytetarët, doja t'i drejtoja disa pyetje, ndër të cilat disa pyetje kanë lidhje me informacionin që kemi marrë dhe disa pyetje, dy pyetje kanë lidhje me atë që unë përfaqësoj këtu, interesin qytetar dhe duke qenë se jam në terren dhe i pranishëm në debate dhe diskutime të ndryshme, doja të dija fillimisht tek raporti i të ardhurave dhe arkëtimeve, na janë paraqitë vetëm vitet 2024-2025. Tani, nëse kërkohet një informacion, do kishte qenë e udhës, mendoj unë, që të paktën të kishim një informacion më të zgjeruar, sepse po bëhet fjalë të japim një raport të qartë, transparent me të gjitha të ardhurat, jo thjesht për një vit, sepse nuk mendoj që këtu bëhet fjalë për një vit. Mendoj t'i shtroj të gjitha pyetjet, pastaj drejtori. Pyetja e parë.

Pyetja e dytë, sa lekë arkëtohen më shumë për bashkinë e Lezhës nga ujësjellësi pas rritjes së tarifave dhe a ka një listë investimesh që të përkthehen këto rritje të ardhurash? Këto kanë lidhje me raportin që ju na keni dërguar dhe informacionin.

Ndërsa pyetja që unë doja t'ju bëja nga diskutimet, nga dëgjesat që kam me qytetarët, sepse ju na shpjeguat rolin tek uji i pijshëm, ujërat e ndotura, ajo që doja të dija duke marrë shkas edhe tek situatat e fundit, çfarë ndërhyrjesh bëni ju si institucion i rëndësishëm në eliminimin e ujit në rrugë në raste të veçanta dhe për ta përmirësuar këtë sistemin e ujërave të bardha dhe e fundit, kryesisht në Shëngjin, sepse atje kam informacione nga diskutime, nga biznesi, nga qytetarë që ju s'jeni të pranishëm në asnjë moment përveç bashkisë së Lezhës. A keni detyrime të tilla apo nuk keni? Faleminderit.

-Ndue Luli: Të vazhdojmë me përgjigjen. Po, drejtor.

-Zef Maçi: Po. Sa i përket rritjes së arkëtimeve, të ardhurat janë 296.080, kurse arkëtimet janë 304,336 për vitin 2024,

-Ka ndërhyrje ku kërkohet informacion për vitin 2000.

-Ndue Luli: Tani diçka, sqarim nga ana jonë, është e vërtetë që është thënë për të informuar për vitet 2024-2025, pasi në fillim të vitit 2024, drejtorja e ujësjellës kanalizimeve Lezhë, kemi qenë në mbledhje te biblioteka, është raportuar për vitet e mëparshme. Besoj se më kuptoni me këtë dhe kryesia e këshillit ka kërkuar informacion për këto dy vite, 2024-2025. Megjithatë, ju jeni drejtues të atij institucioni, mund të themi keni dhe njohjen dhe për vitet e mëparshme, kështu që mund të jepni informacion, sepse jeni në atë punë.

-Erin Ndreca: Nëse mundet të përgjigjet, nëse e kanë si informacion dhe mendoj që të sqarojmë diçka opinionin publik më gjerë.

-Ndue Luli: Vazhdojmë sipas pyetjeve, drejtor. Vazhdo përgjigjen.

-Zef Maçi: Tani problemi është këtu, që unë në vitin 2023 kam raportuar në këshill për periudhën e kaluar, por pas viteve 2000 kanë ndodhur reforma shumë të thella. Në vitin 2000 ka qenë vetëm vetëm vetëm zona urbane e Lezhës e ka pasur ujësjellës kanalizimeve e Lezhës. Në vendimin e këshillit të ministrave 63, 2016 janë marrë të gjitha komunat, të gjitha ujësjellësat e ish-komunave të njësive administrative që s'kanë pasur copë letre, nuk kanë pasur asnjë faturë, nuk kanë trashëguar asgjë, as të ardhura, as shpenzim, asgjë, jo në Lezhë, por në gjithë Shqipërinë. Kështu që s'ka lidhje kjo me vitin 2000. Kanë trashëguar vetëm detyrimet e energjisë elektrike që i kemi paguar kokër për kokër në ujësjellësin e Lezhës, në fakt e kanë pasur për t'i pagu bashkia.

-Pjerin Ndreu: Unë e shoh se këtë shqetësim që keni ju, e kemi ndarë bashkë ne. Mirë është që ta fusim diskutimin në disa hulli të cilat nuk po i shoh.

Më lejoni të bëj një koment, se bashkia është formalisht aksionere 30%, formalisht se faktikisht nuk marr pjesë në bord më, domethënë kam hequr dorë të marr pjesë për arsye se marrëdhënia, mënyra se si është organizuar pas reformës, edhe në padijeninë tonë, edhe në pavëmendjen tonë, shkurt muhabeti, se unë s'e di se kam firmosur ndonjë gjë për 10 vjet, po megjithatë kjo ngelet për t'u parë. Megjithatë, ajo që më ka shqetësuar është tendenca e herë pas hershme për të rritur çmimin dhe nuk është e vërtetë që në 2013 nuk është rritë. Pasi e kemi kundërshtuar ne këtu, është rritur tarifa, në 2024 pra është rritur. Tani ka një problem, në 2024, me reformën e re,

ujësjellësi i Lezhës është bashkuar me Laçin dhe Mirditën. Humbjet tani kanë qenë katastrofale, dhe kanë qenë ndoshta në problematika më të mëdha financiare se ne. Unë jam kurioz me ditë si kryetar bashkie për vete që nuk e di, po në sytë e këshillit dhe në sytë e taksapaguesve lezhjanë, sa është diferenca e lekëve që është mbledhë pas rritjes së tarifës në 2024, në raport me 2023-shin, po themi. A ka mundësi me ba referencën 2023-2024, lëre 2000. Ti ke mbledhur kaq lekë, kaq përqind më shumë lekë, ku kanë shkuar ata lekë? Kanë mbuluar humbjet e dikujt apo janë reflektuar diku? Sepse nëse do i kthehem se mora shkas nga ajo që thotë Erini, për shembull, në Shëngjin, sot mbytet me ujë. E keni ju për detyrë me ndërhy atje dhe nuk merrni asnjë masë, as nuk çoni asnjë mjet, as nuk çoni asnjë punëtor, asnjë. Shkojmë ne si bashki, i bëjmë punët me shërbimet, ndërsa ju jeni inekzistent fare atje. Mirë, nuk bëni investime, se edhe kjo qenka çudi e madhe, as projekt për investime nuk bëni, se i bën bashkia, as ndërhyrje në raste të agravimit të situatës, në Shëngjin mbytet shëtitorja, në Shëngjin mbytet rruga e Kunes, në Shëngjin mbytet rruga kryesore. Atëhere, kush do ta zgjidhë këtë problem? Se unë e nuk e kam kuptuar, kush do të shkojë aty të merret me historinë e ezaurimit të kësaj situatë? Kemi një problem te një pallat këtu në Lezhë, kush e zgjidh atë? Jo po kur është marrë në dorëzim, kur s'është marrë në dorëzim? Duhet të zgjidhet, sepse bie uji në bodrumet e pallatit. Kush do ta zgjidhë? Do ta zgjidhni ju apo do ta zgjidhim ne? Se ju dhe ne, jemi dy të kundërta tashti, s'mund të jemi bashkë më fare. Dhe nëse lekët e taksapaguesve lezhjanë shkojnë me mbushë gropat e gjithë qarkut, këtë duam me ditë ne, sepse ne ujësjellësin nuk e kemi më në funksion të Lezhës për tarifën që paguajmë, është një qasje në mënyrë kategorike, i kanë marrë me një arrogancë shumë të madhe edhe nga qendra që bëjnë çfarë duan vetë, kur vjen puna për me shku me firmos ndonjë gjë, të thërrasin a po vjen me firmos; kur vjen puna për me për me bë një strategji se si bëhet, nuk vjen askush fare, pra ka një qasje shumë të gabuar me ne, dhe unë nuk mund ta pranoj këtë lloj gjëje. Personalisht, ua kam thënë edhe funksionarëve të tjerë të shtetit dhe nuk kam ndër mend me e ul tempin fare, do mbroj interesat e taksapaguesve të Lezhës. Unë as nuk afektoj gjë personalisht, por lekët e taksapaguesve lezhjanë nuk mund të shkojnë me mbyllë gropat e kërkujt. Edhe një rritje çmimi na erdhi prapë me këto mënyra arbitrare. Atëherë, mirë, tha Artani, pse na vini në këshill në qoftë se enti rregullator i ujit e bën vetë, atëherë për çfarë na e sillni? Atëherë, këshilli bashkiak është kthyer në një instrument të paqenë. Unë mendoj që ne duhet të marrim qëndrim ligjor, tash se s'mund të shkojmë ne kështu. Njëri i bie atij shpatit, tjetri i bie këtij shpatit. Për mua është e papranueshme dhe do të jetë e papranueshme dhe nuk pajtohem fare. Unë mendoj që ne duhet të jemi bllok në mbrojtje të 1 leku. Ata janë marrë vesh, edhe kush e bën, edhe si e bën, por nuk do hyjmë më gjatë, ne se do kemi kohë me hulumtu më thellë.

-Ndue Luli: Ju lutem, pyetje, zoti Dod Jaku.

-Erin Ndreca: Nuk është se mora përgjigje për pyetjen, nuk besoj se bëra gabim që bëra një pyetje.

-Ndue Luli: Drejtor, për pyetjen që ka drejtuar zoti Ndreca.

-Zef Maçi: Dhe përgjigjem me shumë dëshirë dhe me shumë profesionalizëm. Kam fytyrën e bardhë, s'më pengon gjë fare.

-Erin Ndreca: Kam, si përfaqësues i maxhorancës, dy pyetje të tjera që i kam duke u lidhur me situatën e fundit, që i kam konsultuar, i kam dëgjuar dhe normalisht unë e shpreh shqetësimin qytetar në mbledhje të këshillit dhe të lutem të përgjigjet.

-Zef Maçi: A më the pse për vitin 2024, pse për vitin 2025?

-Erin Ndreca: Pyetja ishte sa është rritja dhe lista e investimeve ku do shkojnë këto lekë meqë dhe është rritë?

-Zef Maçi: Se ku do shkojnë këto lekë e thashë unë, te të ardhurat e te shpenzimet, aty kanë shkuar. Shpenzimet operative, ne e mbajmë ujësjellësin me 11 milionë lekë të reja, dakord? Sa i prish edhe një shtëpi, kurse pjesa tjetër thamë që shkojnë për paga, shkojnë për energji elektrike, shkojnë për sigurime shqetësore, shkojnë për interesa kredie.

-Erin Ndreca: Domethënë nuk ka asgjë për përmirësim për infrastrukturë.

-Zef Maçi: Investimet kapitale pastaj vijnë nga investitorët.

-Erin Ndreca: Dmth ka vetëm shpenzime, nuk ka investime.

-Zef Maçi: Mbulohen pra se është rritë paga minimale dhe do rritet edhe tani paga minimale nga 40.000 lekë do bëhet 50.000 lekë, dhe shkojnë pastaj dhe për rritjen e pagës minimale.

Tani për sa i përket ujrave të bardha, ne jemi një shoqëri që menaxhojmë furnimin me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujërave të ndotura dhe impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura. Sigurisht që ujërat e bardha janë një problem shumë i madh dhe pjesa kryesore vjen nga punetat e rrugëve, por jo vetëm nga punetat e rrugëve. Ka ndryshuar klima, ka ndryshuar koha dhe rreshjet intensive, po përmbytin. Por tani me këtë projektin e ri, nuk do të ndodhë më për një periudhë afatgjatë.

-Erin Ndreca: Nga projekti i ri, jam dakord, ju si institucion keni një detyrim apo s'keni?

-Zef Maçi: Nuk ka një sistem rrjet kanalizimesh të ujërave të bardha, nuk ekziston. Në gjithë Republikën e Shqipërisë, ujërat e bardha dhe ujërat e ndotura shkojnë bashkë. Të tana ujërat e bardha futen në kolektorin e ujërave të zeza. Pra, në rastin e shirave, stacionet tona kthehen në hidrovor, marrin edhe ujërat e ndotura, por edhe ujërat e bardha.

-Pjerin Ndreu: Si ka mundësi që në Shëngjin, në gjithë këtë amulli, një punëtor uji nuk gjen aty? Si ka mundësi? A ka mundësi shqip, shqip?

-Zef Maçi: Si nuk ka kryetar

-Pjerin Ndreu: Jo, jo, më vjen shumë keq, as edhe një, në gjithë këtë histori që kemi pasur ne aty, kemi shkuar ne duke pastruar ato kunetat, duke marrë zjarrfikësen duke thithë ujë nëpër pika, nëpër gjëra, se ju keni pasur probleme të tjera.

-Zef Maçi: Në gjithë rastet uji ikën me shumë vështirësi, sepse rreshjet janë të shumta.

-Erin Ndreca: A keni të drejtë ose a merrni si institucion i rëndësishëm në rast emergjence, a merrni masa për kunetat?

-Zef Maçi: Ne, për sa i përket punës tonë dhe për përmjetjet, ne i dhamë provat edhe para disa ditësh, para 20 ditësh, që kena ndërhy dhe kena parandalu në të gjitha rastet,

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Dod Jaku.

-Dod Jaku: Përshëndetje, zoti drejtor. Pak a shumë u konsumu dhe ajo pyetja që unë kisha, por në pasqyrat financiare që ju keni bërë, nuk paraqitet ndonjë investim për menaxhimin e këtyre kanaleve të cilat u diskutuan të ujërave të bardha. Tani, pak a shumë e thatë, kush e ka për detyrë mirëmbajtjen dhe zhbllokimin e kanaleve të ujërave të bardha? Ju thatë se janë të dyja bashkë. Unë nuk besoj që janë të dyja bashkë, as nuk duhet të jenë të dyja bashkë. Në qoftë se janë të dyja bashkë, e keni për detyrë ju a e ka për detyrë bashkia? Kjo ishte pyetja ime. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Vazhdoni zoti drejtor.

-Zef Maçi: I nderuar Dod. Unë e thashë që ujërat e bardha nuk kanë rrjet. Nuk ekziston një rrjet i kanalizimeve të ujërave të bardha. Nuk ekziston jo në Lezhë, po kërkund. Ujërat e bardha, ujërat e shiut pra, futen në sistemin e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Janë kunetat e rrugëve që grumbullojnë dhe futen në kanalizimet e ujërave të ndotura. Nuk ka një rrjet kanalizimesh të ujërave të bardha, kurse me këtë investimin e ri që po them, është ndarë sistemi i ujërave të bardha për qytetin e Lezhës, që është projekt pilot.

-Rajmonda Prendaj: Zoti drejtor, punonjësit e ujësjellësit po prishin rrugët, asfaltet e reja. Kush mban përgjegjësi?

-Ndue Luli: Zoti drejtor, vazhdo përgjigjen e pyetjes.

-Zef Maçi: Po, me shumë drejtë, por ne në fakt betonojmë, nuk asfaltojmë rrugët.

Ndodh defekti dhe nuk ke se çfarë bën, duhet me e hapë me e ba.

-Ndue Luli: Fjalën për pyetje e ka zoti Marku.

-Agostin Marku: Faleminderit. Zoti drejtor, unë e di që kur rriten çmimet edhe është fakt ajo që nga 2013 janë rritur vetëm në 2024, por rritja në 2024 ka qenë e tillë sa ka krijuar shumë probleme edhe tek qytetarët, edhe tek biznesi, edhe tek institucionet shtetërore. Kur i njëjti shërbim është, e njëjta cilësi është dhe është rritë çmimi, dhe unë mendoj se këto vijnë nga rritja e kostos së shërbimit. Ndaj kam disa pyetje vetëm mbi bazën e tabelave të treguesve financiarë që keni sjellë ju. Unë shoh që struktura e shpenzimeve vetëm për paga dhe sigurime shoqërore, në totalin e shpenzimeve, pa kredinë dhe interesat, ju keni 53%. Mos është një tregues që ka ndikuar fiktivisht në rritjen e çmimit? Ndërsa ndaj totalit, duke përfshirë dhe kreditë, kjo strukturë është 37% të gjithë shpenzimeve tuaja. Tani, ne e dimë se janë bërë investime kolosale në ujësjellësin e Lezhës, që kanë meritën, pse jo, edhe institucioni që ju drejtoni, por merita i shkon qeverisë shqiptare, sepse marrëveshjet edhe gjithçka tjetër me këta donatorë, qeveria i ka realizuar. Tani, në këto kushte, unë dua të di sa është kapaciteti për mbledhjen e ujit me këto investime që janë realizuar për tju përgjigjur qytetarëve, sa nga ky kapacitet që ju keni harxhuar energji elektrike, etjera, etjera, për ta mbledhur këtë ujë, sa është faturuar? Dhe po ecim vetëm me 2024 dhe 2025, unë nuk po them për vitet e tjera. Sa është faturuar, sa është mbledhur, sa është humbja në rrjet? Dhe dua të di edhe një tregues tjetër: sa janë detyrimet e pambledhura dhe

nga këto, sa janë nga familjarë, sa janë nga entet shtetërore dhe sa janë nga entet private? Sepse të gjitha këto kanë të bëjnë me menaxhimin. Unë nuk dua të hyj aty, jo ujërat e bardha, jo ujërat e zeza. Realisht, kjo quhet ndërmarrja e ujësjellës kanalizimeve dhe ka si objektiv, me sa di unë, çështjen e ujit të pijshëm, ka dhe të përpunimit të ujërave të zeza. Nuk hyn te ujërat e bardha, deri më sot. Sot e mbrapa varet se çfarë statusi merr. Por përgjigja e këtyre, saktësimi i këtyre del edhe në konkluzion pse rritja e çmimit dhe si është menaxhu kjo ndërmarrje gjatë kësaj periudhe. Faleminderit.

-Ndue Luli: Zoti drejtor, vazhdoni me përgjigjen e pyetjes.

-Zef Maçi: Po. Tani, të ardhurat vijnë nga zhvillimi i aktivitetit të shitjes së ujit të pijshëm dhe kanalizimit të ujërave të ndotura. Dhe për vitin 2024, e theksova, janë 296.018 lekë. Për vitin 2025, janë 309.100 lekë. Pra, kanë ardhur në rritje të ardhurat. Ndërsa të ardhurat e arkëtuara janë 304.336. Pra, janë mbledhë dhe detyrime të prapambetura. Për vitin 2024 dhe për vitin 2025, janë 319.691 arkëtimet. Në çdo rast, pra arkëtimet janë më shumë se të ardhurat e faturuara. Pra, janë vjelë vazhdimisht dhe detyrimet e prapambetura nga konsumatorët familjarë në përgjithësi, sepse biznesi nuk ka detyrime të prapambetura. Tani, në shtjellimin e çështjes thatë edhe që, pra, duhet të dihet se ku shkojnë këto para. Unë ju thashë që, shifrat janë kokëfortë dhe ju thashë që shpenzime ne si si kompani, kena bërë 11 milionë lekë të reja. Si ku shkojnë paratë? Paratë shkojnë për pagesat e punonjësve, paratë shkojnë për energji elektrike, paratë shkojnë për shlyerjen e principialit të kredive.

-Agostin Marku: Unë nuk thashë ku shkojnë, se unë i kam parë. Unë di me lexu. Unë thashë struktura e pagave.

-Zef Maçi: Menaxhimi është perfekt. Pra, në qoftë se nuk ruhet një menaxhim perfekt, ndërmarrja del jashtë kontrollit.

-Agostin Marku: Më fal se nuk e kam akon me ndërhy. Shiko, e kam thjesht me sqaru pyetjen që unë drejtoha, jo për tjetër, se nuk ndërhyj. Tani, në këtë unë nuk thashë ku kanë shku, se unë e lexova se ku kanë shku, si kanë shku dhe po ta marrim atë shifrën që thoni ju, 11 milionëshin, ajo është shumë e vogël. Bie në njëjtën linjë me ju. Por unë po të them ky tregues 53%, a është një pikëpyetje e madhe?

-Zef Maçi: Tani, ju nuk jeni vetëm një këshilltar, por edhe një specialist shumë i zoti. Sepse ke drejtuar lloj lloj institucionesh dhe ke aftësi për të bërë pyetjet e nevojshme. Por këto pyetje shumë të rëndësishme, më ndihmojnë shumë edhe mua për t'ju shtjelluar. Unë jam një drejtues që e kam fytyrën e bardhë. Asnjë njeri në Republikën e Shqipërisë dhe në Lezhë përgjatë 35 viteve nuk mundet, nuk ka shans që unë mund të kem kryer një punë për interes ose për një kafe. Dhe jam në gjendje dhe jam i aftë dhe shumë i moralshëm për të debatuar me çdokend dhe për të dhënë llogari gjithkujt.

Tani, është shumë e drejtë, pra, pyetja juaj shumë profesionale që a thu që shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore janë të mëdha? Pra, unë të falenderoj shumë për pyetjen. Ne, shoqëria ujësjellës kanalizime Lezhë, ka gjysmën e punonjësve që kryejnë tre funksione: është roje stacioni, është faturist dhe elektropompist. Në mënyrë që do të kishte katër veta ai stacion dhe ka

një, kompania duhet të kishte 355 veta si organikë me mbulu, ashtu siç duhet stacionet e pompimit dhe rezervuarët e ujit sipas ligjit. Ne, në fakt, kemi 134. Dhe çfarë ndodh? Dhe të gjithë, pra, punonjësit kanë pagën minimale. Dhe që nga viti 2023 që jemi bërë shoqëri rajonale, është në nderin tonë që ju jeni njësia bashkiake që përbëni shumicën e aksioneve duke përjashtuar Ministrinë e Punëve Publike të qeverisë shqiptare. Pra, çfarë dua të them me këtë? Kemi bërë revolucion administrimin dhe përmirësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në Laç dhe Mirditë. I kemi bërë shtet. Nuk kanë pasur faturë, nuk kanë pasur të ardhura. I kemi dixhitalizuar prej te tunelet e Thirrës në Krujë e deri në Kraj, me komplet sistemin. Dhe gjatë kësaj periudhe, kena ulë numrin e fuqisë punëtore me 34%. Dhe kena ulë shpenzimet, kena rritë të ardhurat, të ardhurat e arkëtuara në qytetin e Laçit që kanë shkuar 140%, që s'është pa kund në histori. E njëjta gjë dhe në Mirditë. Pra, nuk shkojnë të ardhurat tona për to. Ne i kemi kthyer pothuajse në rentabilitet edhe ato kompani. Dhe detyrimet e prapambetura që kanë patur, se është shumë çështje e rëndësishme dhe thelbësore kjo që ta kuptoni që t'ju informoj që detyrimet e prapambetura për ujësjellësin e Laçit dhe të Mirditës nuk i paguajmë ne. Do t'i shlyejë shteti shqiptar, reformën e ka bërë qeveria shqiptare. Dhe është reforma më e suksesshme në 30 vitet e fundit që po synon që t'i kthejë kompanitë e ujësjellësve në vetëfinancim. A më kupton? Për të përballuar përmirësimin e sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të ujërave të zeza.

-Ndue Luli: Fjalën për pyetje, zonja Haxhia.

-Donika Haxhia: Unë do dal nga pasqyra ekonomike. Nuk jam as kompetente shumë aty. Tani, nuk do flas as për të ardhurat e faturuara, unë do flas për faturat. Megjithatë, pyetja po më digjet pak se po e kuptoj pse nuk vijnë faturat në shtëpi. Në qoftë se ai faturisti i shkretë, paska dhe dy punë të tjera me bë, nuk vijnë faturat atëherë. në dijeninë time i paguajmë në rajfazen, a ka ndonjë plan për ta shtrirë për personat që i paguajmë online, apo do të mbeteni vetëm aty? Flas për të bërë pagesën e faturave. Dhe pyetja tjetër: uji i pijshëm që ne pimë dhe e paguajmë për ujë të pijshëm, a është i pijshëm? Sasia e klorit që dhe hidhet në këtë ujë, unë tani thashë unë nuk jam as kimiste, por fakti që një ditë uji ka një sasi shumë të lartë klori, sa nuk bën dot as dush, nuk lan dot as enët, s'bëhet fjalë me e përdorë për gatim, krahasuar me një ditë tjetër kur sasia e klorit është, se ndihet. Për faktin që është i ndryshëm, do të thotë që ka ditë që është i papijshëm, ditë që është i pijshëm, nuk durohet disa ditë dhe kam nevojë për siguri si qytetare, si konsumatore e ujit. Faleminderit.

-Ndue Luli: Zoti drejtor, po?

-Zef Maçi: Pyetje shumë e rëndësishme, siguria e ujit.

Klorifikimi i ujit të pijshëm realizohet me injeksion, pra është automatikisht, klorifikohet në stacionet e pompave në Barbullojë me injeksion. Por në rastin e përmbytjeve, në rastet që janë frikë për sëmundje, ne në bashkëpunim dhe me Institutin e Shëndetit Publik dhe Shëndetit Parësor Lezhë, e rrisim dozën e klorit. Dhe uji i Lezhës është garant për t'u pirë. Dhe unë e pi. Por nuk e kalon asnjëherë sasinë e lejuar.

Për sa i përket pagesave, pagesat kryhen në arkat tona, paguhen pranë postave, dhe tani i kemi bërë dhe me çdo pikë, mund të paguhen dhe me kartë. Pra, mund të paguajmë jo vetëm cash, por mund të paguajmë edhe me kartë, me anë të shërbimit pos.

-Ndue Luli: Zoti Doda ka fjalën, pas jush e ka zoti Gjinkola.

-Zek Doda: Unë e kisha në lidhje me pagesën. Janë disa firma private të cilat paguhen dritat, paguhen shumë gjëra aty. Uji i Lezhës nuk paguhet. Njëra prej atyre firmave që e kam unë, puna ime private, më është thënë që nuk më është dhënë firma e drejtorit.

-Zef Maçi: Jo, është e drejtë pyetja, është i drejtë dhe komenti që bën. Është e vërtetë. Jo se nuk e ka dhënë firmën drejtori por sepse procesi i vjeljes së të ardhurave të ne, janë arkat tona të shërbimit të klientit, janë postat në gjithë rrethin e Lezhës, janë dhe bankat. Kurse a mundet, a duhet që si thoni ju? Sigurisht që dhe kjo do të bëhet për sistemi jonë i faturim arkëtimit që është ekzistues dhe që janë gjeneru për këtë kapitull, nuk i përfshijnë këta operatorët ekonomikë privat dhe është një gjë që i shërben, dhe në të ardhmen do të bëhet.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Pyetja e parë, uji i Shëngjinit a është i pijshëm?

Pyetja e dytë, Zoti drejtor, a jeni në dijeni ju si ndërmarrje se komplet sistemi i ndërtimeve të Shëngjinit nuk ka në mënyrë absolute, nesër kur bëni investimin tjetër ju, linjë indirekte, e ka direkte që do të thotë do të jetë shkatërruese për çdo familje në Shëngjin, presioni i ujit, nëse do të jetë me këtë sistem se nuk është me rikthim.

E treta, kur është bërë ujësjellësi i dytë i Shëngjinit e ka bërë investimin komuna nëpërmjet qeverisë dhe stacioni i pompave në vend që me u vu në Barbullojë me katër pompa, u vu me dy dhe u vu në Ishull Lezhë dhe për pasojë uji i Shëngjinit gjithë kohën vjen me mbetje të degradume, si me thënë në thellësi të tokës. Dhe më bën përshtypje një gjë, në momentin kur ju e morët në dorëzim me gjithë këto lloj pasojash, më bën përshtypje mënyra tash sepse është ba dhe një gabim tjetër me ujin se kur vihen në punë pompat e kënetës, të Ishull Lezhës që do të thotë linja e Shëngjinit që e ka bërë komuna vjen uji i qelbët dhe për mua duhet të jetë një ndër gabimet më të rënda se keni bërë. Pra në vend që me ba shërbim me standart, keni prishë edhe standartin, keni prishë gjithçka. Kaq kisha.

-Ndue Luli: Ke ba pyetje dhe përgjigje vetë zoti Pjetër dhe ke mbaru dhe diskutimin.

Fjalën e ka drejtori për sqarimet.

-Zef Maçi: Ujësjellësi i Shëngjinit ka prodhimtari uji dhe stacione më vete. Janë në Ishull Lezhë, kjo për arsye sepse e thatë që është investim i buxhetit të shtetit por ato stacione kanë shku atje sepse me i afër stacionit të pompave në Barbullojë, marrin ujë te stacioni i pompave, pra studimet hidrogeologjike atje e kanë përcaktuar për me i hap, kjo është arsyeja pra se sigurisht do kishte qenë shumë më mirë që të ishin më afër, sa më afër por nuk ka ujë sa më afër, atje e ka qitë studimi hidrogeologjik.

Shëngjini është në qytetet që janë pagëzu ka herë po ka vetëm emrin Shëngjin, nuk është më Shëngjini që ka qenë. Shëngjini është 30-fishu dhe vazhdon me intensitet të lartë pjesa e ndërtimeve dhe ai uji që është fillon e ndahet pastaj te konsumatorët. Dhe në Lezhë është me depozita dhe edhe nga bisedat që kena bërë edhe personale bashkë, këtë vit e kemi lënë 24 orë pra nuk e kena ndërprerë ujin fare për qytetin e Shëngjinit, as tani në dimër kurse në të ardhmen

për sa i përket diferencave të presioneve që ti trajton, është shumë e drejtë por në ndërtimin e ujësjellësit të ri sigurisht pastaj që do të merren në konsideratë dhe do të bëhet pa depozita, do të bëhet si ujësjellësi i Lezhës. Sivjet u bë një ndërhyrje, kemi ndërtu 5 km të magjistralit kryesor të Shëngjinit dhe është përmirësu ndjeshëm bashkë me disa zgjidhje novatore që kena ba në stacionin e pompimit duke rritë prodhimtarinë. Unë mendoj që edhe me investimet e tjera të fazës së dytë që do të bëhet do të zgjidhet edhe problemi i ujësjellësit të Shëngjinit sepse është zonë prioritare dhe shpresohet për një turizëm elitare.

Çmimi i ujit i Lezhës për metër kub ujë dhe kanale është ndër çmimet më të lira të Republikës së Shqipërisë dhe është me ngritje mekanike, ka ujësjellësa që janë me vetërrjedhje, ne nuk jemi me vetërrjedhje pra nuk e marrim ujin nga Zoti, ujin e prodhojmë me shumë kosto dhe çdo pikë ujë që prodhojmë dhe çdo pikë ujë i ndotur që e largojmë dhe çdo pikë ujë që e trajtojmë, e trajtojmë me energji elektrike dhe çmimi i ujit, për njësinë Lezhë për vitin 2026 dhe për vitin 2027 nuk do të ketë rritje sepse ne kena kërku me ngulm Entit Rregullator të Republikës së Shqipërisë, që deri sa të bëhet unifikimi i faturave të ujit të pijshëm i Lezhës me Mirditën dhe me Laçin, pra që të barazohen, çmimi i Lezhës nuk do të rritet, as për 2026, as për 2027.

-Ndue Luli: E qartë drejtor. Atëhere për pyetje zoti Tonin e ka fjalën.

-Tonin Jaku: Dy pyetje kisha, dëmtimet në infrastrukturë publike të rrugëve dhe gjatë difekteve pse nuk i parashikoni materialet ju, pyetja e parë.

E dyta, për ujrat e zeza, nuk do bëhet asnjë investim kësaj rradhe?

Këto kisha, faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit zoti Tonin.

-Zef Maçi: Faleminderit zoti Tonin. Kjo pyetja e parë që e tha edhe një zonjë tjetër që është shumë e drejtë pra ne bëjmë defekt edhe hapim se s'kemi nga të shkojmë pa e hapë, por nuk jena në gjendje me asfaltu. Ne e betonojmë dhe pastaj bisedojmë edhe me inxhinierët e bashkisë se kur është mundësia që të asfaltohen por kjo është përgjegjësi e jona që të asfaltohen, po me pasë asfaltim duhet me pas marrëdhënie kontraktore me një subjekt dhe një subjekt nuk dëgjon me ba kontratë për shembull për 2 m asfalt ose për 3 m asfalt.

Kurse për sa i përket ujërave të zeza, e thashë unë që ujërat e zeza deri tani në Lezhë në të gjithë Shqipërinë janë të kombinuara ujërat e bardha që futen në kolektorët dhe kanalizimet e ujërave të ndotura dhe shkojnë në stacionet e pompimit të ujërave të ndotura dhe në këtë rast thashë kthehen në hidrovor, pra a do të kenë përmirësim ujërat e zeza, do të kenë përmirësim, pse do të kenë përmirësim, sepse ato ujërat që janë hedhur deri tani nëpër kolektorët e ujërave të zeza nuk do t'i mbingarkojnë kolektorët e ujërave të zeza sepse do të kenë rrjetin e vet të sistemit pra, të këtij rrjeti të ri që po ndërrohet enkas për ujërat e bardha.

-Ndue Luli: Zonja Marku e ka fjalën.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Unë në fakt desha vetëm me bë një sqarim në vazhdimësi të pyetjeve, pretendimeve që kryetari i grupit të këshilltarëve, siç u shpreh, të mazhorancës, kishte në fillim të kësaj dëgjese me përfaqësues të drejtorisë rajonale të ujësjellës kanalizimeve.

Së pari më vjen mirë që ju sot jeni qartësu se me të vërtetë rritja e tarifës së ujit të pijshëm ka qenë e pavend, ndryshe nga qëndrimet tuaja publike të barabarta me heshtje para një viti e gjysëm kur një pjesë pakicë e jona publikisht ka mbajtur qëndrimin që nuk ishte koha, nuk ishte vendi që për qarkun Lezhë dhe konkretisht për bashkinë Lezhë të rritej mbas 10% tarifa ujë të pijshëm.

Ndryshe nga shumë institucione të tjera të qarkut Lezhë që refuzojnë të vijnë në këshill dhe të raportojnë, Përfaqësues të Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizime Lezhë vijnë këtu shumë dinjitozë edhe flasin para këshilltarëve.

Unë ju ftoj që përpara se të duartrokisni ato reformat e qeverisë qendrore të keni durimin dhe të uleni dhe të lexoni se ai ngërçi ku ne ndodhemi sot si këshill bashkiak edhe si bashki nuk vjen nga strukturat bashkiake të ujësjellësit por vjen pikërisht nga reforma e organizimit në nivel rajonal të ujësjellësave pas marrëveshjes së datës 22 korrik të vitit 2022 dhe sipas kësaj marrëveshjeje është ministria e infrastrukturës dhe energjisë që zotëron 51% të aksioneve në çdo strukturë rajonale të ujësjellësave, ndërkohë ne si bashki pavarësisht se jemi tre kemi zero autoritet për vendimmarrje sepse kemi vetëm 49% të aksioneve ky është problemi jonë, se heshtim kur duartrokasim reformat por nuk e dimë se çfarë pasojash sjellin, se me këtë reformë si bashki ashtu dhe këshillat bashkiake e kanë dorëzuar drejt pushtetit qendror autoritetin e vetëqeverisjes vendore dhe sa kohë furnizimi me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellës kanalizime është shërbim që ofrohet në nivel vendor dhe paguhet nga qytetarët e bashkive respektive rrjedhimisht edhe autoriteti për vendimmarrje përfshirë këtu edhe rritjen apo uljen e tarifave të ujit të pijshëm, duhet të jetë i joni si këshill bashkiak, i propozuar pse jo dhe nga bashkitë respektive, por jo të nënshtrohem ne politikave të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë apo entit rregullator të ujësjellësit që varet drejtpërdrejt nga ky autoritet qendror.

Unë kam vetëm një pyetje, e kam mbrojtë edhe para një viti e gjysmë që nuk ishte momenti për ta rritë tarifën e ujit të pijshëm në bashkinë e Lezhës, absolutisht që jam dakort edhe e vlerësoj, jam shumë e lumtur që në Lezhë po kryhen investime për përmirësimin e rrjetit të ujësjellës kanalizime, janë kredi që merren siç edhe e shpjeguan zotërinjtë, nga qeveria shqiptare dhe që paguhet nga qytetarët, por edhe këto investime nuk do të ishin miratuar për bashkinë e Lezhës nëse ne si bashki apo drejtoria rajonale e ujësjellës kanalizimeve nuk do të ofronte një situatë garante për financimin, pra nuk do të ishte një zonë e sigurtë për financimin. Duhet të justifikosh që po punon që të marrësh investime vijuese.

Unë kam vetëm një pyetje, unë e kam edhe raportin për të ardhurat e mbledhura në 2023-shin, ka ka rritje. Ne si këshill bashkiak falë zotit kemi rënë dakort të gjithë që të marrim një nisëm me mbështetjen edhe të bashkisë Lezhë për të ulë tarifën e ujit të pijshëm për bashkinë e Lezhës. Uroj që edhe dy bashkitë e tjera të Qarkut ta bëjnë. Nga ana juaj pavarësisht, se unë jam e qartë për kompetencat e kufizuara, ia kemi dhuruar me dashje pushtetit qendror kompetencat për të vendosur edhe për tarifën e ujit të pijshëm, por nga ana juaj si drejtori rajonale e ujësjellësit për tre bashki a do të kemi mbështetjen për uljen e tarifës së ujit të pijshëm?

Kërkoj edhe një konfirmim tjetër, unë e kam marrë përgjigjen gjatë diskutimeve por të ardhurat ne i projektojmë në nivel njësie bashkiake, po shpenzimet i projektojmë po në nivel njësie bashkiake të ujësjellësit apo në nivel strukture rajonale të ujësjellësit? Faleminderit.

-Ndue Luli: Fjala për ju drejtor.

-Zef Maçi: Faleminderit shumë. Tani kjo është pyetje kështu shumë e vështirë për t'u përgjigjur por unë po përgjigjem ashtu siç është e drejtë dhe siç është kompetenca që kemi.

Ulja e tarifave të ujit të pijshëm është e pamundur për efekt të kostove dhe të kredive por thashë që për vitet 2026 dhe 2027 nuk do të ketë rritje të tarifave pavarësisht se Enti Rregullator e kërkon çdo vit për rishikimin e tregut, deri në një rast kur në kuadrin e shoqërisë rajonale, njësia e shërbimit Mirditë, Njësia e shërbimit Laç, do t'i bëjnë tarifat sa tonat.

Ne kështu e kena propozu dhe vjet, që të unifikohen tarifat në gjithë zonën e shërbimit.

Të ardhurat vijnë si njësi shërbimi Lezhë, po shpenzimet a janë, po janë shpenzimet e njësisë së shërbimit Lezhë, pra janë të ardhura të faturuara për njësinë bashkiake Lezhë dhe janë të ardhurat e arkëtuara për njësinë bashkiake, pra nuk paguajmë ne për ata dhe unë në qoftë se mundeni dhe në qoftë se ma jepni këtë lumturi që do të them diçka dhe për vitin 2023 që në asnjë rast ne nuk shlyejmë detyrime. I kena vu në vijë ato, do të mbulojnë kostot njësitë e shërbimit Mirditë dhe Laç dhe u janë rritë tarifat 50% atyre për me kapë mbulimin e kostos. Dhe për vitin 2023 për shlyerjen e detyrimeve të energjisë të ardhurat e arkëtuara kanë qenë 264343 lekë pra dhe çfarë është e rëndësishme për të thënë, që energjia elektrike e vitit 2023 është subvencionuar nga buxheti i shtetit për bashkinë Laç

-Ndue Luli: Para se t'i jap fjalën zotit Nderca, duhet të sqaroj, është e vërtetë që drejtori i shërbimit të ujësjellës kanalizimeve Lezhë ka qenë i gatshëm sa herë e kemi kërkuar për të dhënë informacion në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm por edhe për shërbimin e kanaleve të ujërave të zeza.

Duhet të sqaroj zonjën këshilltare se tha je i vetmi dhe të tjerët s'na kanë ardhë, se të gjitha atyre institucioneve që këshilli bashkiak u ka dërguar njoftim për të ardhur për të dhënë informacion për një problem të caktuar, absolutisht nuk ka asnjë që s'ka ardhur. A duhet që ne t'i thërrasim më shpesh, a duhet që ne t'u kërkojmë llogari atyre për shërbimet që duhet të japin ndaj qytetarëve të Lezhës? Patjetër që po.

Fjalën e ka zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Atëherë, drejtor nëse pyetjet të vënë në siklet, të lutem na e thua drejtpërdrejt pa avokat mbrojtës. Unë mendoj dhe e shikoj që çdo pyetje sado e sikletshme të jetë për secilin prej nesh, mendoj që është një sqarim dhe një lehtësim për këdo prej nesh, si ne që i drejtojmë, si ju që përgjigjeni. Asnjë moment nuk vendos interes personal në pyetjet që bëj, koha ka treguar që nuk kam marrë pozicione që t'i nënshtrohen dikujt.

Kam prapë një pyetje, mbase do të jetë e sikletshme, por është e drejtëpërdrejtë nga një qytetar i Balldrenit dhe kam pyetje tjetër që e kam qoftë për ty qoftë edhe për bashkinë, mbase Fatjoni.

Pyetja e parë është që, thotë që në Balldren ju mbani taksën e ujërave të ndotura, ndërkohë që ne kemi të gjithë gropa septike dhe nuk ka kanalizime, tani a është e vërtetë a s'është e vërtetë, pyetje e drejtëpërdrejtë nga një qytetar.

Dhe pyetja e dytë që kam, e kam përsëri në raport me investimin që po bëhet, me investimin tek kanali tek rruga Shtraus nga banorët e zonës aty, që bëhet fjalë që mos gabofsha aty është një kolektor tek pallati i Martinit afër shkollës së Rogacionistëve, thonë që është një degëzim që del tek kanali që po vishet me beton, a është e vërtetë, sa është e vërtetë dhe nëse është e vërtetë kjo veshja që do i bëhet kanalit mund të rrezikojë mbylljen e këtij dhe për pasojë ky kolektor pastaj të shpërthejë në një të ardhme, jeni në dijeni apo duhet të ngrihet një komision që ta vërtetojmë sepse ma kanë shprehur disa herë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Të lutem drejtor konçiz përgjigjet e pyetjeve sepse kemi edhe një pikë tjetër.

-Zef Maçi: Faleminderit shumë zoti Ndreja. Inxhinier unë nuk kam siklet për me u përgjigjë, është kënaqësi, ndihem shumë i lumtur dhe ndihem shumë mirë kur ju sqaroj, po ndihem keq kur s'mund t'ju sqaroj tamam.

Pyetja është që një banor i Balldrenit thotë që nuk ka rrjet kanalizim të ujëra të ndotura dhe ai paguan kanalizim. Në fakt është shumë e vërtetë, njëherë ai banori i Balldrenit ka 24 orë ujë të pijshëm dhe nuk i është ndërprerë uji kurrë, tash e nëntë vjet, për sa i përket kanalizimeve nuk ka rrjet publik të kanalizimeve të ujërave të ndotura por konsumatorët e zonës urbane pra të Lezhës dhe të Shëngjinit dhe të zonave përreth të Ishull Lezhë, Ishull Shëngjin dhe Balldren, e paguajnë tarifën e kanalizimit të ujërave të ndotura tarifën e ujit të pijshëm, i shërbejnë me bot në çdo kohë për pastrimin e gropave septike gjithkujt.

-Ndue Luli: E qartë drejtor. Fjalën e ka drejtori i shërbimeve, ka një problematikë që ka lidhje me informacionin në fjalë.

-Jurgen Marku: Atëherë vetëm një sugjerim të vogël kisha për sa i përket pjesës së materialeve që u cek pak më parë, lidhur me pjesën e ndërhyrjeve që bëhen në infrastrukturë, kisha sugjeruar që te materialet të ishte parashiku asfalti i ftohtë, praktikisht me të njëjtën procedurë funksionojmë dhe neve si drejtori shërbimesh por është është diçka pak problematike sepse ne nuk mund të parashikojmë herë pas here mbylljen e gropave të hapura nga ujësjellës kanalizimet, kështu që e kisha lënë si sugjerim që te pjesa e parashikimit të materialeve të kishin marrë në konsideratë dhe vlerësimin për asfalt të ftohtë.

-Zef Maçi: Është e drejtë dhe ne do ta kena parasysh. Unë kam një komunikim të vazhdueshëm me bashkinë dhe një bashkëpunim të shkëlqyer dhe merremi vesh për çdo defekt për çdo gjë që ne po hapim, a ta hapim, a mos ta hapim, ose do ta hapim dhe do ta bëjmë dhe e betonojmë por në të ardhmen do ta mendojmë.

-Ndue Luli: Ka kush gjë tjetër në lidhje me këtë pikë? S'ka.

Atëhere informacioni i fundit është në lidhje me realizimin e buxhetit për 11 mujorin e vitit 2025. Këtë informacion secili e ka pasë, në qoftë se do ketë ndonjë problem kemi zv/kryetarët e bashkisë këtu.

-Erin Ndreca: kam edhe diçka të fundit te “Të ndryshme”.

-Ndue Luli: Nuk ka në lidhje me informacionin.

Atëhere “Të ndryshme”.

Do ta them diçka përpara se e thashë, në lidhje me zgjedhjen e kryetarëve dhe të anëtarëve të kryesive në fshatrat të cilat dihet që kryetarët kanë qenë të emëruar nga kryetari i bashkisë, përcaktuam dhe datat dhe kalendarin në këto fshatra.

Në lidhje me problemin që ngriti zonja Marku dhe që e kemi ngritur dhe disa herë të tjera, është shumë e drejtë, duhet t’ju informoj se bashkia nëpërmjet drejtorisë së shërbimeve, meqënëse kemi dhe drejtorin këtu, ka nisur në qytet punën për zgjedhjen e administratorëve të pallateve. Ne si këshill do të përfshihemi për zgjedhjen e ndërlidhësve sipas bllokut të pallateve, sipas ligjit dihet që ndërlidhësi duhet të ketë mund të themi një juridiksionin e vet rreth 20.000 banorë, ne nuk e plotësojmë si qytet që të kemi lagje me 20.000 banorë, kështu që ne së bashku do ta studiojmë në mbledhjen më të afërt pasi ta diskutojmë edhe me drejtorinë e shërbimeve, me bashkinë, do ta diskutojmë se në sa blloqe mund ta ndajmë qytetin e Lezhës, në mënyrë që për secilin bllok të ketë një ndërlidhës dhe do përfshihemi ne pastaj, ne si këshill, për zgjedhjen e ndërlidhësve sipas këtyre blloqeve, pra do ndërtohet një hartë, kjo do dalë edhe nga urbanistika se do të jetë e saktësuar mirë.

Tani fjalën e ka zoti Ndreca për probleme të ndryshme

-Erin Ndreca: Kisha në një shqetësim dhe do kisha pasur dëshirë të ishte kryetari.

Ajo që doja të thoja është një shqetësim që e kam personal dhe e kam të dëgjuar edhe nga të tjerë dhe doja të ishte kryetari mbase edhe për shkak jo thjesht të profesionit po edhe të profesionit në të shkuarën e tij. Është një situatë në Lezhë kur shoh ankesa nga shumë qytetarë për shkak të sulmeve që ka marrë policia shteti me gjoba, patjetër që kur kondicionet e infrastrukturës nuk janë në kushtet optimale dhe njerëzit janë të detyruar të parkojnë mbase për një shërbim pesë minutësh, këta gjejnë një gjobë. Nëse është e mundur të ketë tolerim brenda kornizave ligjore, nuk them unë që të shkelë ligjin asnjë njeri, jam kundër asaj, por të gjendet një marrëveshje që t’i ndihmojmë qytetarët jo mezi të ngremë ato kurthet për t’i kapë për t’i gjobitë. Diçka e tillë më ka ndodh dhe mu. faleminderit

-Ndue Luli: Problem tjetër.

-Alfrida Marku: Unë kisha vetëm një problematikë, të gjithë e dimë që në vitin që kaloi kemi miratu disa lista të pronarëve për dokumentimin e pronës së tyre, tokë bujqësore, nga përdorim në pronësi. Unë e kujtoj në atë kohë që përfaqësuesi i drejtorisë përkatëse të bashkisë theksoi që aktualisht janë rreth 800 praktika pezull, nga verifikimi, nga komunikimi me qytetarë, nga komunikimi edhe me punonjësit e bashkisë, por edhe duke lexuar kompetencat, më rezultoi që këto vonesa vijnë drejtpërdrejt si rezultat i mosveprimit me apo pa dashje nuk e di, nga agjencia shtetërore e kadastrës, edhe unë kërkoj që njëjtë sikurse sot ne kishim përfaqësues të ujësjellës kanalizime drejtoria rajonale Lezhë, unë kërkoj që në mbledhjen e radhës ne të kemi në këshillin bashkiak për të raportuar për këtë problematikë por pse jo dhe të tjera drejtues të ASHK-së

agjencisë shtetërore të kadastrës, Dega Lezhë. Janë me qindra ankesa të drejta të qytetarëve për vonesa për regjistrimin e pronave të tyre apo ndryshime të tjera. Faleminderit.

-Ndue Luli: Qartë, atëherë ka tjetër? po zonja Seferaj.

-Gjuljana Seferaj: Atëherë është një problem për lagjen Kodërmarleka, faktikisht, është ajo zona ku ka ken Casa Ola, se tani është bërë qendër për personat me probleme të ndryshme. Nuk e di tani a është problemi i rrugës i ujësjellësit se është hap ajo rruga që ka kenë asfaltu shumë mirë aty e kur është ba ujësjellësi i ri, është kthy rruga në një gjendje skandaloze sinqerisht.

-Fatjon Zefi: Është pjesë e projektit dhe asfaltimi, kthimi në gjendjen fillestare. Nuk mund ta mbulojmë pa bërë testimin, kështu që pa përfunduar testimin.

-Gjuljana Seferaj: Është edhe një rrugë tjetër, është një rrugë ku janë mbi 200 familje se përfitojnë nëse ajo rrugë shtrohet edhe bëhet, është diku te 150 m rrugë por realisht është në gjendje të mjerueshme, sa herë aty bie shi bëhet një përmbytje katastrofike, edhe të mendosh se njerëzve u hyn uji dhe Brenda, ka nga ato familje që u përmbyten shtëpitë, është një rrugë shumë e shkurtër.

-Ndue Luli: Atëherë zv/kryetari e ka fjalën për sqarim.

-Fatjon Zefi: Do më sjellësh rrugën, ose planvendosjen, ose lokacionin, ta verifikojmë se mbase mund të jetë te rrugët e parashikuara në 2025-2026 ose përndryshe ta marrim në shqyrtim.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka ndonjë gjë tjetër? S'ka. Atëherë ju falenderoj për gjithçka. Mirupafshim në mbledhjen e ardhshme.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Floride Çunaj


KRYETARI

NDUE LULI
